

**Në prag të Samitit**  
**Të sigurt drejt NATO-s**

Fq.3



**HULUMTIM I "BB 2018"**

**Të sigurt në punë, pak besim te institucionet**

Fq.7



**Ku është puna e gjuhës shqipe?**

Fq.11



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3407 · E shtunë/e diel, 7-8 korrik 2018

20°C | 26°C

15 DEN



**KOHA për enigmë**

Fq.12-15

## FORUM

**Të (mos) jesh Zaev**



Tregojnë një anekdotë për djalin e Lubço Georgievskit, kur kishte qenë 3-4 vjeç, posa ishte zgjedhur i ati kryeministër. E kishin pyetur çka punon babai, ai ishte përgjigjur: "Branko Cërvenkovski". Sepse babai i Lavit posa ishte bërë "Branko Cërvenkovski dhe ai si një i mitur kishte barazuar kryeministrin me personin që e kishte ushtruar atë post...

Fq.10

## RAJON

**Vuçiç: Serbia do të zhduket**

Fq.16

## GLOBI

**Në fokus "Russiagate", lufta hibride dhe Ballkani**

Fq.17

## EDITORIAL

**Shtetësia dhe etnia**

Fq.2



## MAQEDONIA NË NUMRA

# MBYLLET EDHE NJË DEKADË E PLAKJES



Sipas të dhënave zyrtare, vitin e kaluar - grupmosha 0 deri në 14 vjeç përbën vetëm 16.5 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërkohë që popullsia e moshës së tretë - mbi 65 vjeç, është rritur. Gjatë dekadës së fundit, trendi negativ i shtimit të popullsisë është ndikuar edhe nga shifrat gjithnjë e më të vogla të kurorëzimeve, por edhe numrave në rritje të divorceve. Në periudhën 2007-2017 martesat janë zvogëluar me 11 për qind, ndërsa numri i divorceve është rritur me mbi 40 për qind

Fq.4

## Nga mjekësia përfundojnë mësues të anglishtes

Shkup, 6 korrik - Në Maqedoni mund të kesh ndjekur çfarëdolloj shkollimit të mesëm, të kesh dhënë cilëndo lëndë si provim të maturës shtetërore dhe të mos kesh asnjë kufizim apo prioritet për degën në të cilën do të regjistrohesh studimet. Pra mund të kesh mësuar katër vite në ndonjërin prej shkollave të mesme të mjekësisë, të kesh dhënë provim mature gjuhën angleze dhe mund të pranohesh në

fakultetin e arkitekturës, drejtësisë, ekonomisë, arteve e kështu me radhë. Kjo praktikë, për njohësit e arsimit duhet ndryshuar sa më parë, pasi bëhet shkak i mungesës së kompetencave profesionale sa u takon kualifikimeve. Një prej arsyeve kryesore që ka sjellë deri në këtë situatë është edhe mungesa e një mekanizimi i cili do të bënte orientimin e hershëm të nxënësve, respektivisht do të...

Fq.4



## EDITORIAL

SHTETËSIA  
DHE ETNIA

Emin AZEMI

Shtetësia dhe etnia, nuk janë e njëjta gjë. Ti mund të jesh shtetas i një shteti, por kjo nuk nënkupton me automatizëm se shtetësia është sinonim i përkatësisë etnike. Pra, me fjalë të tjera, ti me shtetësi mund të jesh amerikan, por me etni shqiptar. Pse ngatërrohen këto nocione, kur dihet se bota këto gjëra i ka rregullu para nesh. Nëse me marrëveshjen e re Shkup- Athinë përcaktohet shtetësia e atyre që banojnë në Maqedoninë e Veriut, kjo në asnjë mënyrë nuk do të duhej të na shqetësojë neve si shqiptarë, sepse, si edhe deri më tani, etnia jonë edhe në të ardhmen nuk do të evidentohet nëpër pasaporta.

Identiteti shtetëror nuk e përjashton atë etnik nëse ky raport rregullohet shumë qartë në kushtetutën e vendit. Nëse përkatësia etnike e shqiptarëve shkrihet në identitetin shtetëror dhe kjo ngrihet në kategori kushtetuese, atëherë ky është problem. Ndryshimet kushtetuese që priten të ndodhin do të duhej të kuptohen si detyrime të Shkupit zyrtar kundrejt Greqisë në të gjitha ato dimensione ku mund të ketë indicie për pretendime të mundshme territoriale. Por, në asnjë mënyrë statusi i shqiptarëve nuk paraqet kurrfarë pretendimi territorial ndaj Greqisë nëse ai inkorporohet me të gjitha atributet shtetformuese që në instancë të fundit nuk e prishin kohezionin e brendshëm të shtetit.

Mund të del ndonjë ministër grek dhe ti ftojë shqiptarët të mos dalin në referendum, se gjoja ata "nuk ndjehen mirë në një shtet sllav", por qëllimi i këtij apeli ka konsum të brendshëm politik, sepse ai synon të dështojë kjo marrëveshje, jo për të mirën e shqiptarëve, por për të mirën e partisë së tij e cila çamët i quan "kriminelë" dhe "bashkëpunëtorë të nazistëve". Nacionalizmi i këtyre ministrave grekë i adresohet elektoratit në Greqi dhe fare pak halleve e problemeve tona këtu.

Shqiptarët në Maqedoni mund të kenë një mijë e një arsye për të mos dalur në referendumin e vjeshtës, por ata nuk kanë as zero arsye të bëhen leva që lëvizin dhe përmbysin baraspeshat politike në Greqi. Aq më pak, të bëhen levë e një nacionalisti ( ministri grek i Mbrojtjes, Panos Kammenos), duke rënë në grackat e gjoja përkujdesve të tija ndaj të ardhmes së shqiptarëve të cilët "nuk duhet të jetojnë në shtet sllav". Në Ballkan në të kaluarën kishte më shumë përpjekje për të bërë aleanca që bashkon të këqijat e përbashkëta, se sa beteja të përbashkëta për sëpecifika të veçanta që si pikësynim kanë të ardhmen më të mire. Edhe në Greqi ka kundërshtarë të normalizimit të marrëdhënieve në mes të Athinës e Shkupit, ashtu siç ka në Beograd plot fundërrina nga koha e Millosheviqit të cilët kohën ende e masin me aksionin e koduar "Patkoi", që si synim kishte pastrimin e Kosovës nga shqiptarët. Kopje të tilla millosheviqiane ka edhe në Shkup dhe të gjithë së bashku këta eksponentë të nacional-shovenizmit ballkanik duan ti frenojnë proceset euro-integruese, në favor të agjendave të tyre proruese e anti-NATO.

Shqiptarët në Maqedoni duhet të luftojnë politikisht e kulturalisht që të bëhen pjesë e këtij shteti, jo si qiraxhinj, por si pjesë integrale e shtetndërtimit, duke u bërë kështu faktor stabiliteti dhe integriteti për të mirën e tyre dhe të tjerëve. Referendumi i vjeshtës është një shans reale të demonstron edhe njëherë rëndësia e faktorit shqiptar, duke "ofruar" (e jo vetëm duke "mos u pajtuar"), zgjidhje konkrete që do ta fuqizonin këtë dimension faktorizues. Gjithkush që refuzon një ide politike, duhet ta zëvendësojë me një ide tjetër. Bile edhe kjo nuk mjafton. Duhesh të grumbullosh rreth vetes një masë kritike njerëzish (të paktën nja 100 mijë veta) që do ta përfaqësonin atë ide. Cili nga kundërshtarët e referendumit mund ta bëjë këtë. Nëse e bënë, unë do të jem i pari që do ti bashkangjitem. Nëse jo, do të jem i fundit. Edhe-edhe nuk ka. Edhe të kundërshtosh, edhe të rrih në shtëpi të "punosh në Facebook". Dhe pastaj ku mbeti mobilizimi politik?!

LUFTA E JENIÇERËVE TË DJESHËM BËHET  
EDHE SOT

"Moslejimi apo mospranimi i vendosjes së shtatores të urtarit tonë më të madh Profesor Anton Çettës para Institutit Albanologjik të Prishtinës është një refuzim gjenetik i një negacioni të përvijuar të një lufte gjysmëshekullore të kryeklanëve të pështirë të të ashtuquajturit Qark Kulturor i Prishtinës. Profesori i brezave të shquar të Albanologjisë së Kosovës, eruditi dhe urtari i rrallë i gjithë diturisë shqiptare, edhe para plot 44 vjetësh që dëbuar nga Dega e Letërsisë Shqiptare prej të njëjtës gardë jeniçerësh që sot plotësisht njësoj synon ta dëbojnë edhe shtatoren e Tij nga vendi që ata mendojnë se kryepari i tyre është pronari legjitim i asaj copë toke, të cilën kurrë nuk e ka blerë dhe nuk ka kurrfarë tapie as merite për të! Përkundrazi, ai atë tempull të dijes e ka keqpërdorur që më se gjysmë shekulli dhe të njëjtën gjë vazhdon ta bëjë edhe sot e deri në varr!

Derisa Kosova nuk ka pushtet të vërtetë e as pushtetarë të civilizuar me kulturë e dije, të cilët së paku do t'i njihnin përafërsisht vlerat që nuk duhet lejuar të cenohen kaq poshtërsisht, duhet vetë qytetarët e kulturuar të Prishtinës dhe të gjithë Kosovës të marrin në duar këtë çështje dhe ta vendosin atë duke e zgjidhur me trimëri e ndershmëri, para së gjithash me kulturë e qytatari, siç i pati zgjidhur Profesori ynë i lavdishëm të gjitha nyjat më të kobshme që na i patën lidhur fatkeqësitë e jetës nën robërinë sllave dhe asaj të injorancës pseudointelektuale të jeniçerëve të djeshëm e të sotëm!", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, poeti Shaip Beqiri.

## TURP! TURP! TURP!

"Na mendoni për budallenj, a si? Por jo, o zonja e zotërinj, deputete e deputetë, s'mund të përdorni këtë logjikë, Pazarin e Ri dhe Këndin e lojnavë të Liqeni, apo amfiteatrin, po aty si garanci se edhe projekti juaj për teatrin do jetë patjetër sukses! Aq më pak s'mund të paraqesni si sukses katrahurën e qendrës së Tiranës, por kjo është temë tjetër. Sepse kushdo që jeton në Tiranë prej 40-50 vjetësh do bënte disa pyetje: Kishte dikur një Kinema 17 Nëntori, një Republika, një Partizani, një Ali Demi, ç'u bënë këto katër kinema?

Kishte dikur një Muze të Shkencave të Natyrës, ku është ai? Kishte një park lojnash për fëmijët, të rruga e Elbasanit, në fillim u përgjysmua, pastaj... ç'u bë ky park?

Kishte një Institut Folklori, ndërtesë ku ka qenë Radio Tirana e vjetër, ndërtesa po rrënohet, mos do kalojë dhe kjo pronë private e pastaj...? Kishte një Kinema verore, diku pranë vendit ku ndodhej dhe Çadra e cirkut... ku janë këto?

E pra, e keni bërë Tiranën për faqe të zezë... fjetore, e më keq se fjetore, po ia merrni frymën. Dhe nëse koncepti juaj i së bukurës pajtohet edhe me pamjen aktuale të Sheshit Skënderbej, atëherë keni probleme të rënda, sidomos të personalitetit. Po si mund të ngrini kartonat e të votoni për të ndërtuar në qendrën historike të Tiranës atë batërdisht që parashikon plani i Kryeministrit? TURP! TURP! TURP!", ka shkruar në profilin e saj në Facebook, botuesja dhe e bija e Mitrush Kutelit, Atalanta Pasko.

## MEDIACitate

Sipas raportit më të ri të Stejt Departamentit Amerikan, Kosova është burim dhe destinacion për meshkuj, femra dhe fëmijë që i nënshtrohen trafikimit të seksit dhe punës së detyruar në mbarë Evropën. "Shumica e viktimave janë vajza dhe janë pjesë e tregtisë interne njerëzore për eksploatim seksual, derisa grupet kriminale në Kosovë i detyrojnë femrat nga Shqipëria, Moldavia, Rumania, Serbia dhe vendet tjera evropiane, që të prostitutojnë.

Në të njëjtën kohë, fëmijët nga Kosova, Shqipëria dhe shtetet fqinje, janë të detyruar të kërkojnë lëmshë brenda Kosovës. Korrupsioni në qeveri krijon një rreth që mundëson krime të caktuara me tregtinë e njerëzve", thuhet në këtë raport.

Më tutje sipas këtij raporti, Kosova është ranguar në 'nivele 2' në të cilin gjendet edhe Serbia. Në të njëjtin raport vlerësohet se qeveria e Kosovës 'nuk i plotëson as minimumin e standardit për eliminimin e tregtisë së njerëzve', por ajo 'bën përpjekje të ndjeshme që kjo të ndryshojë'. Gratë dhe vajzat e reja janë subjekt i tregtisë së seksit në shtëpi dhe banesa private, klube të natës dhe sallonet për masazh.

(Gazeta Zëri, 6 korrik)

Nga mesdita e së mërkurës e deri këtë të premte, 520 goditje tërmeti e kanë origjinën nga zona e Gjirit të Lalzit. E gjithë Shqipëria është e rrezikuar nga tërmetet, për shkak të aktivitetit të dendur tektonik, sidomos në zonat bregdetare jonike dhe adriatike.

Ashtu si tërmeti mbi 6 ballë i ditës së mërkurës, me epiqendrë në zonën e Gjirit të Lalzit, i cili prej më shumë se dy ditësh shoqërohet vazhdimisht me tërmete të tjera.

"Aktiviteti vazhdon, numërohen rreth 520 pasgoditje, ku më e forta përveç të mërkurës, 4.2 ka qenë ajo e orëve të para të mëngjesit, me magnitudë 4.3 të shkallës Richter", tha Edmond Dushi, sizmolog. Epiqendra e tërmeteve mbetet e njëjta zonë, Gjiri i Lalzit.

(Gazeta Shqip, 6 korrik)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## KU NDODHET GAJTANI?

Gajtani është vendbanim i fortifikuar ilir i kohës së hekurit mbi një kodër të veçuar në verilindje të fshatit Gajtan 5 km në lindje të Shkodrës (gërmimet janë bërë më 1961-1962). Vendbanimi është rrethuar me një mur mbrojtës, i cili është ruajtur mirë në anën e jugut, në një gjatësi afro 90 m. Ai është ndërtuar me blloqe gurësh të mëdhenj e mesatarë të paskalitur e me lidhje të thatë. Ka

gjërësi të përgjithshme 3.5 m, nuk ka kthesa e kulla. Shtresa më e hershme kulturore i takon bronzit të vonë e fillimit të epokës së hekurit. Kjo ndiqet nga shtresa kulturore e periudhës së hekurit të zhvilluar, gjatë së cilës vendbanimi ka pasur jetë intensive. Shtresa tjetër kulturore pas shek.IV p.e.s. vjen deri në kohën e vonë antike, kur ndërpritet edhe jeta në qytezën e Gajtani.

MAQEDONIA AFËR MARRJES SË FTESËS NË SAMITIN E BRUKSELIT

# TË SIGURT DREJT NATO-S

Zaevi ka qenë aktiv muajve të fundit si në vizita në shtetet e rajonit, siç ishte ajo e fundit në Sarajevë me kryeministrin e Bosnjës, ashtu dhe në vendet kryesore të BE-së, sidomos në Gjermani, ku ndonëse vizitat ishin të natyrës ekonomike, në prapavije ishte sigurimi i mbështetjes dhe lobimit gjerman për marrjen e datës për hapje për negociatave me BE-në dhe marrja e ftesës për në NATO

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 6 korrik - Samiti i radhës i NATO-s që do të mbahet javën e ardhshme më 11 dhe 12 korrik në Bruksel, do të jetë vendimtar për Maqedoninë, e cila pritet të marrë ftesë për anëtarësim. Drejt sigurimit të ftesës - Qeveria e Maqedonisë, gjegjësisht kryeministri Zoran Zaev ka bërë përpjeke të mëdha duke lidhur Marrëveshje për fqinjësi të mirë me Bullgarinë dhe Marrëveshje për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë. Po ashtu, Zaev ka qenë aktiv muajve të fundit si në vizita në shtetet e rajonit, siç ishte ajo e fundit në Sarajevë me kryeministrin e Bosnjës, ashtu dhe në vendet kryesore të BE-së, sidomos në Gjermani ku ndonëse vizitat ishin të natyrës ekonomike, por në prapavije sipas qarqeve diplomatike, kanë qenë sigurimi i mbështetjes dhe lobimit gjerman për marrjen e datës për hapje të negociatave me BE-në dhe marrja e ftesës për në NATO.

Se Maqedonia do të marrë ftesë për anëtarësim në NATO në Samitin e javës së ardhshme të Aleancës, e tha të premten edhe lideri i BDI-së, Ali Ahmeti pas takimit që pati me ambasadorin e Zvicrës në Shkup, Sybille Suter Tejada. Muajin e kaluar, shtoi Ahmeti, përfituam edhe datën për fillim të negociatave për anëtarësim në BE. Paraprakisht Qeveria greke ka dërguar letër NATO-së se janë hequr të gjitha pengesat që kanë ekzistuar më herët që Maqedonia të merr ftesë për anëtarësim.

## MAJK PENS I TELEFONON ZAEVIT DHE CIPRASIT

Në prag të këtij Samiti, zëvendës-presidenti i SHBA-ve, Majk Pens, ka zhvilluar një bisedë telefonike me kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev dhe me kryeministrin grek, Aleksis Cipras. Këtë të fundit e ka uruar për marrëveshjen e arritur me Maqedoninë për çështjen e emrit. "Kryeministri grek ka theksuar rëndësinë që ka kjo marrëveshje për stabilitetin dhe zhvillimin e përbashkët rajonal", njoftojnë nga kabineti i kryeministrin grek, Aleksis Cipras. Pens dhe Cipras, përveç marrëveshjes, kanë biseduar edhe



për raportet politike greko-turke dhe rolin e Greqisë në rajon, por edhe për përforcimin e marrëdhënieve ekonomike greko-amerikane, në veçanti në prag të Panairit Ndërkombëtar që do të mbahet në Selanik në mesin e muajt shtator, ku SHBA-ja do të jetë mysafir nderi i Panairit.

## CIPRAS: BALLKANI KA ARDHMËRI DINAMIKE

Më tone pozitive është mbajtur edhe Samiti katër palësh i kryeministrave të Rumanisë, Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë në Athinë. Si kryeministri Vuçiq dhe ai bullgar Borisov, ashtu dhe kryeministri grek Aleksis Cipras ka folur për një perspektivë të re të rajonit të Ballkanit Perëndimor pas Marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Bullgarisë dhe marrëveshjes për emrin me Maqedoninë. Para një viti ndoshta ishte e paparamenduar se do të arrihet, por tani Marrëveshja historike e Prespës është fakt dhe jep perspektivë për rajonin, tha kryeministri Aleksis Cipras pas përfundimit të takimit katërpalësh në Selanik, me kryeministrat e Bullgarisë dhe Rumanisë dhe me presidentin e Serbisë. Duke folur për rajonin, Cipras u kthye disa vite më herët, ka bërë krahasim të situatës atëherë dhe tani, "Pothuaj askush nuk ka pritur se do të ndryshohen aq gjëra. Këtë vit, e kemi pasur edhe Marrëveshjen historike nga Prespa, e cila para një viti, ndoshta dukej e paparamenduar se do të arrihet. Por, tani është fakt dhe e vendos bazën për zgjidhjen e një çështjeje mjaft të rëndësishme, duke dhënë perspek-

## IVANOVI: ZAEV PO GËNJEN OPINIONIN

Presidenti Gjorge Ivanov demantoni ashpër, siç tha ai, gënjeshtret e kryeministrin Zoran Zaev të shpalosura gjatë intervistës për televizionin grek ERT, se gjoja edhe presidenti do të përkrahë marrëveshjen me Greqinë. "Kryeministri Zaev me qëndrimet e tija konfuzë, kontradiktore dhe të ndryshueshme po vazhdon të gënjejë dhe manipulojë jo vetëm opinionin vendas dhe grek por edhe atë ndërkombëtar. Anëtarësimi i Maqedonisë në NATO dhe Bashkimin Evropian nuk



guxojnë të keqpërdoren për pranimin e një marrëveshjeje të dëmshme për shtetin maqedonas dhe vetë maqedonasit", thuhet në kumtesën e dërguar nga kabineti i presidentit të shtetit. Presidenti i Maqedonisë nuk pranon marrëveshjeje e cila është e dëmshme për identitetin maqedonas dhe e dëmshme për interesat e Republikës së Maqedonisë. Qëndrimi i presidentit Ivanov është i pandryshueshëm dhe nuk do të përkulet para asnjë lloj presioni apo kërcënimi.

tivë të re për tërë rajonin tonë", tha Cipras. Lidhur me ardhmërin e rajonit, kryeministri grek theksoi se Ballkani ka ardhmëri dinamike, mjaftë është të ekzistojë vizion, besim, por edhe guxim. "Vlerësoj se para nesh kemi ardhmëri dinamike për Ballkanin, mjaftë është të kemi vizion dhe besim në forcat tona, vizion për rajonin tonë dhe ndonjëherë të jemi të guximshëm. Të jemi të guximshëm që të bëjmë hapa përpara, madje edhe nëse duhet shumë herë këto hapa të jenë në kundërshtim me zhvillimin normal. Por, me këto hapa vetëm mundemi t'i vendosim bazat e Ballkanit evropian, për Ballkanin demokratik, i cili nuk do të maltrohet nga lloje të ndryshme të nacionalizmit, fobisë, introversionit ose inercionit, por fuqimisht do të orientohet drejt zhvillimit dhe bashkëpunimit të përbashkët", tha Cipras. Ndërkohë në Maqedoni ne interes të sigurisë në rajon në poligonin ushtarak Krivolak u zhvillua "Kampusi veror 2018" ku morë pjesë 11 shtete. Me këtë rast Ministrja e mbrojtjes Radmilla Shekerrinska tha se me anëtarësimin e

Maqedonisë në NATO do të rritet potenciali në Krivolak dhe se do të jetë pozitive për imazhin e Maqedonisë, ekonominë e vendit, por edhe ekonominë e rajonit. "Poligoni Krivolak është një nga kapacitetet që ka Maqedonia që t'ia ofrojë edhe aleancës së NATO-s dhe partnerëve tanë. Edhe deri tani kemi bërë stërvitje të përbashkëta me disa shtete të rajonit dhe disa vende me të cilët kemi partneritet. Megjithatë, anëtarësimi ynë në NATO do t'i vendosë theks më të madh kësaj mundësie. Kjo do na e japë shansin ta paraqesim Maqedoninë si vend që nuk kërkon, por edhe vend që ka se çka të ofrojë. Edhe këtë vit do të keni rastin dhe gjatë muajit korrik të shihni se një pjesë e forcave speciale të Amerikës do të kryejnë ushtrimet të përbashkëta këtu në Krivolak. Presim këtë vit, këtë verë të kemi ushtarë amerikanë shtesë që janë prezent në rajon, që të ushtrojnë bashkë me ushtarë nga Maqedonia", ka thënë Radmilla Shekerrinska. Ajo ka shtuar se Maqedonia punon që të përbushë gjitha kriteret, njëherësh duke përbushur edhe të gjitha standardet.

Menjëherë pas marrjes së ftesës sfida më e madhe do të jetë mbajtjen e referendumit për ndryshimin e emrit të shtetit. "Referendumi për emrin e Maqedonisë do të zhvillohet më 23 ose 30 shtator ose më 7 tetor dhe qëllimi është që të përfundojnë të gjitha detyrimet e planifikuara deri më 15 janar, deklaroi kryeministri Zoran Zaev, në një intervistë për televizionin shtetëror grek ERT. Ai shpjegon se referendumi do të ketë një karakter të detyrueshëm, do të pranohet nga të gjithë, madje edhe nga presidenti Ivanov. Duke iu përgjigjur një pyetjeje lidhur me afatet për palën maqedonase Zaev thotë se qëllimi i vendosur është 15 janari. Zaev shpjegon se pas Samitit të NATO-s më 12 korrik, debati mbi referendumin do të hapet më 23 shtator, 30 shtator ose 7 tetor dhe pastaj do të ketë një periudhë prej tre muajsh për ndryshimet kushtetuese. Zaev shpreh bindjen e tij se referendumi do të jetë i suksesshëm sepse "qytetarët tanë duan miqësi me Greqinë dhe duan integritet me BE dhe NATO" dhe i zbulon pyetjet e mundshme.

MAQEDONIA NË NUMRA

# MBYLLET EDHE NJË DEKADË E PLAKJES

Sipas të dhënave zyrtare, vitin e kaluar - grupmosha 0 deri në 14 vjeç përbën vetëm 16.5 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërkohë që popullsia e moshës së tretë - mbi 65 vjeç, është rritur. Gjatë dekadës së fundit, trendi negativ i shtimit të popullsisë është ndikuar edhe nga shifrat gjithnjë e më të vogla të kurorëzimeve, por edhe numrave në rritje të divorceve. Në periudhën 2007-2017 martesat janë zvogëluar me 11 për qind, ndërsa numri i divorceve është rritur me mbi 40 për qind



tare të Entit Shtetëror të Statistikës, vitin e kaluar grupmosha 0 deri në 14 vjeç përbën vetëm 16.5 për qind të numrit të përgjithshëm, ndërkohë që popullsia e moshës së tretë, mbi 65 vjeç është rritur.

Gjatë dekadës së fundit, trendi negativ i shtimit të popullsisë është ndikuar edhe nga shifrat gjithnjë e më të vogla të kurorëzimeve, por edhe numrave në rritje të divorceve, duke arritur që në total shtimi natyror i popullsisë të arrijë deri në 1436. Gjatë 2007-2017, martesat janë zvogëluar me 11 për qind, ndërsa numri i divorceve është rritur me mbi 40 për qind.

Zonat e banuara kryesisht me shqiptarë janë ato që gjatë kësaj

dekade të fundit kanë kontribuar pozitivisht në reduktimin e minuseve në qytete dhe fshatra me popullsi me shumicë dërrmuese maqedonase. Tetova, Çairi, Strugë, Saraj, por edhe Likova e Studeniçani janë ndër komunat ku shkalla e lindjeve, martesave është gjithnjë në rritje, për dallim nga përqindjet e vogla të vdekjeve, apo divorceve.

“Sa i takon strukturës së moshës, popullsia në Maqedoni vjen duke u plakur gjithnjë e më shumë. Në periudhën mes viteve 2007 deri më 2017 popullsia më e re (mosha 0-14 vjeç) është reduktuar nga 18.5 për qind në 16.5 për qind, ndërsa popullsia në moshë të shtyrë (mbi 65 vjeç) është rritur, nga 11.4 për

## STATISTIKA VITALE GJATË 10 VITEVE

### VITI 2007

15.490 kurorëzime (7.6 për qind kurora në 1000 banorë)  
1417 divorce (0.6 për qind në 1000 banorë)  
22.688 foshnje (11.1 për qind foshnje në 1000 banorë)  
19.594 të vdekur (9.6 për qind në 1000 banorë)

### VITI 2017

13.781 kurorëzime (6.6 në 1000 banorë)  
1994 divorce (1.0 në 1000 banorë)  
21.754 foshnje (10.5 për qind foshnje në 1000 banorë)  
20.318 të vdekur (9.8 për qind në 1000 banorë)

qind sa ishte dhjetë vjet më parë në rreth 14 për qind. Ndryshimet në strukturën e moshës së popullsisë kanë reflektuar edhe në numrin e personave të vdekur. Kështu shkalla e mortaliteti është rritur duke shkuar deri në 9.8 për qind”,

thuhet në raportin më të fundit të ESHS-së të titulluar “Maqedonia në numra”.

Për dallim nga zonat urbane, ku mesatarja vjetore e shtimit të popullsisë nuk e kalon shifrën 415, në fshatra arrin deri në 1021 perso-

Koha

Evis HALILI

Shkup, 6 korrik - Nëse në fillimet e viteve 2000, të rinjtë përbënin gati 20 për qind të popullsisë së përgjithshme të Maqedonisë, dhjetë vjet më vonë - statistikati japin alarmin për reduktimin e kësaj grupmoshe. Sipas të dhënave zyr-

## MUNGESA E MEKANIZMAVE PËR ORIENTIMIN E NXËNËSVE

# NGA MJEKËSIA PËRFUNDOJNË MËSUES TË ANGLISHTES

Problemi nis që nga mungesa e sistemit të klasifikimit dhe orientimit të nxënësve nga shkolla e mesme në universitete, për të përfunduar më pas te mungesa e kufizimeve për regjistrimin e tyre në degë sipas fushave përkatëse. Në pamje të parë, kjo situatë mund të shihet si fryma liberale në arsim, por që në të vërtetë është burimi i anarkisë që mbizotëron në sistemin arsimor

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 6 korrik - Në Maqedoni mund të kesh ndjekur çfarëdolloj shkollimit të mesëm, të kesh dhënë cilëndo lëndë si provim të maturës shtetërore dhe të mos kesh asnjë kufizim apo prioritet për degën në të cilën do të regjistrosht studimet. Pra mund të kesh mësuar katër vite në ndonjërin prej shkollave të mesme të mjekësisë, të kesh dhënë provim mature gjuhën angleze dhe mund të pranohesh në fakultetin e arkitekturës, drejtësisë, ekonomi-



së, arteve e kështu me radhë. Kjo praktikë, për njohësit e arsimuar duhet ndryshuar sa më parë, pasi bëhet shkak i mungesës së kompetencave profesionale sa u takon kualifikimeve.

Një prej arsyeve kryesore që ka sjellë deri në këtë situatë është edhe mungesa e një mekanizmi i cili do të bënte orientimin e hershëm të nxënësve, respektivisht do të rregullonte kalimin e tyre nga njëri në nivelin tjetër të shkollimit bazuar në aftësitë dhe dhuntitë e nxënësve. Por, mungesa e këtij mekanizmi ka bërë që pjesa dërrmuese e nxënësve, dhe studentëve

të mos kenë një vijimësi në drejtimin e shkollimit referuar në drejtime apo profile të caktuara.

Kështu, në kuadër të arsimit filor mungojnë testet e vlerësimit të aftësive dhe dhuntive që posedojnë nxënësit si dhe të mekanizmave të ngjashëm pedagogjik të cilët do të stimulonin ende më tepër zhvillimin e atyre dhuntive me qëllim të orientimit të nxënësve drejt shkollave profesionale. Çdo herë duke vënë si prioritet harmonizimin e dhuntive të nxënësve, respektivisht studentëve me nevojave e tregut të punës. Pra është pikërisht mos funksionimi i këtyre

mekanizmave që nga njohës të arsimit vlerësohet si problem me ndikim të lartë edhe në rënien e cilësisë në arsimin në përgjithësi. Për pasojë vijmë në situata kur ata që regjistrohen në shkollën e mesme të mjekësisë përfundojnë studiet të gjuhës angleze, ekonomisë apo inxhinierë ndërtimi, ndërsa ata që kanë mbaruar gjimnazet bëhet mjekë, farmacistë apo stomatologjisë.

Në pamje të parë, kjo situatë mund të shihet si fryma liberale në arsim, por që në të vërtetë është burimi i anarkisë që mbizotëron në sistemin arsimor. Sipas Nuhi



NUHI DARDHISHTA

**Në rast të funksionimit të sistemit i cili do të orientonte nxënësit sipas aftësive dhe dhuntive që kanë, jo vetëm që secili do ta gjejë veten në vendin e vet, por do të jenë shumë më të larta edhe rezultatet e mësimave. Nxënësit, kuptohet që do të ndjehen shumë më kompetent në fushën ku i kanë orientuar mësimet dhe studimet e tyre, pra do të japin maksimumin e tyre. Dhe në instancë të fundit do të jenë shumë më cilësore edhe rezultatet që ato do të japin gjatë mësimin apo studimit**

Dardhishtës, kryetar i Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptarë “Naim Frashëri” në Shkup, është shumë e nevojshme të ndërmerret diçka me qëllim të përmirësimit të kësaj si-

na. Pesë rajonet ku popullsia po "vdes" nga viti në vit janë Pellagonia, popullsia e së cilës vetëm gjatë vitit të kaluar numëroi 920 persona më pak, Lindori (minus 488), Juglindori (minus 140), Vardari (minus 90). Rajoni ku shtimi i popullsisë është jo vetëm pozitiv, por edhe më i lartë është Shkupi, me mbi 2000 persona.

Edhe në këtë rajon shtimi ndodh kryesisht nëpër fshatra, ku numri i lindjeve vazhdon të jetë më i lartë. Po ashtu, edhe rajonet që banojnë kryesisht nga popullsi shqiptar, si ai i Pollogut, ku ritmet e shtimit të popullsisë mbeten të larta mbi 890 persona në vit. Karakteristike për zonën e Pollogut është se dallimi mes fshatit dhe qytetit është i vogël dhe popullsia shtohet thajse njësoj.

"Shtimi natyror në të gjithë Maqedoninë ka tendenca negative në pesë rajone. Popullsia në zonat urbane përbën rreth 29 për qind të numrit të përgjithshëm, kundrejt zonave rurale ku popullsia rritet me mbi 72 për qind", konstatohet në analizën e ESHS.

Faktorë të tjerë që ndikojnë negativisht në pakësimin e numrit të popullsisë, e për rrjedhojë edhe plakjen e saj, janë emigrimet kryesisht tek moshat e reja. Saldo e migrimeve është më e madhe në rajonit e Shkupit, ku të paktën zyrtarisht figurojnë mbi 1200 persona që largohen në vit, ndërsa shifrat më të ulëta janë në rajonin Verilindor gjatë vitit të kaluar.

tuatë. "Në rast të funksionimit të sistemit i cili do të orientonte nxënësit sipas aftësive dhe dhuntive që kanë, jo vetëm që secili do ta gjejë veten në vendin e vet, por do të jenë shumë më të larta edhe rezultatet e mësimeve. Nxënësit, kuptohet që do të ndjehen shumë më kompetent në fushën ku i kanë orientuar mësimit dhe studimet e tyre, pra do të japin maksimumin e tyre. Dhe në instancë të fundit do të jenë shumë më cilësore edhe rezultatet që ato do të japin gjatë mësimit apo studimit", vlerëson Dardhishta.

Por, realiteti në Maqedoni flet për një situatë krejt ndryshe dhe për Dardhishtën, problemi nis që nga mungesa e sistemit të klasifikimit dhe orientimit të nxënësve nga shkolla e mesme në universitete, për të përfunduar më pas te mungesa e kufizimeve për regjistrimin e tyre në degë sipas fushave përkatëse.

"Në të gjitha universitetet e Maqedonisë, qofshin publike aspo private nuk ka kufizime në pranimin e studentëve bazuar në shkollimin paraprak të tyre dhe lëndën e provimit të maturës shtetërore. Këtë ua mundësojnë vetë universitetet", pohon kryetari i LASH-it. Pra, sipas tij, maturanët nuk ka pse të lodhen të zgjedhin matematikën provim mature, kur dihet se për përvetësimin e kësaj lënde nevojitet shumë më tepër punë se sa për mësimin e gjuhës angleze.

**Nga zyra e Avokatit të Popullit është dorëzuar deri te ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe një iniciativë, në të cilën qëndrojnë rekomandimet se si në të ardhmen në mënyrë të mirëfilltë të mbrohen të drejtat e fëmijëve**

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 6 korrik - Ligji për sigurim shëndetësor të ndryshohet dhe i njëjti të harmonizohet me nevojat qenësore të qytetarëve të Maqedonisë. Kjo është një nga vërejtjet që vijnë në zyrën e Avokatit të Popullit, e që kanë të bëjnë me mosharmonizimet ligjore dhe të drejtat e fëmijëve. Dispozitat e ligjit aktual duhet të përputhen me Konventën për të drejtat e fëmijëve, dhe në këtë drejtim janë në procedurë të plotësim-ndryshimit nga zyra e Avokatit të Popullit. Për të mos u përsëritur rastet e llojit të "Tamarës", bie fjala, nga zyra e Avokatit të Popullit, thonë se deri te ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe është dorëzuar një iniciativë, në të cilën qëndrojnë rekomandimet se si në të ardhmen në mënyrë të mirëfilltë të mbrohen të drejtat e fëmijëve. Kjo nismë e Ombudsmanit, ka filluar pasi që muaj më parë deri te zyra për ankesa është pranuar një parashtrësë nga një qytetar i vendit i cili ka kërkuar ndihmë për padrejtësitë që i bëhen nga Fondi për sigurim shëndetësor.

"Në emër të fëmijës së tij, një prindi i ka dorëzuar ankesën, ku ka shprehur pakënaqësinë e tij lidhur me procedurën të cilën e ka zhvilluar Fondi për sigurim shëndetësor (Qendra rajonale Shkup) për vulosjen e një vërtetimi për shfrytëzimin e aparatit për dëgjim. Si rezultat i gjendjes së fëmijës, në fund të vitit 2016 i është operuar dhe i janë instaluar impjante në vesh. Për këtë arsye ka lindur edhe nevoja e përdorimit të aparatit për dëgjim. Problemi në fjalë ka ndodhur në prill të këtij viti, në çastet kur prindi është drejtuar në sportelin e Fondit, kurse shërbimet përkatëse nuk ia kanë vulosur vërtetimin për marrjen e baterive për aparatit e dëgjimit. Arsyetimi i shërbimeve të Fondit ka qenë se vërtetimi nuk mund t'i vazhdohet pasi që të ëmës i ka kaluar statusi i personi të siguruar, respektivisht fëmija të drejtën e sigurimit mundet ta shfrytëzojë pas 6 muajve, nga koha kur si sigures social është paraqitur babai i tij", thuhet në shkresën dërguar

## "Titanik 2" vazhdon më 27 gusht

Në këtë lëndë të akuzuar janë lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi, ish-drejtori i DSK-së, Sasho Mijallkov, si dhe ish anëtarët e KSHZ-së, Bedredin Ibraimi, Aneta Stefanovska, Vllatko Sajkovski dhe Sasho Srceç

Shkup, 6 korrik - Me dëgjimin e dëshmitarëve Boris Kondarko, Violeta Duma, Subhi Jakupi dhe Vasil Kërstev, gjykimi për lëndët e PSP-së "Titanik 2" do të vazhdojë më 27 gusht. Në seancën e djeshme janë lëshuar dy incizime të "bombave" ku dëgjohej se si ish drejtori i DSK-së, Sasho Mijallkov bisedon me kryetarin e PDSH-së, Menduh Thaçi dhe tregon se nevojitet që anëtar i PDSH-së të votojë për ankesën e KSHZ-së për vendotimin 1727 në Strumicë. Në incizimin e dytë dëgjohej se si Menduh Thaçi i lajmërohet anëtarit të KSHZ-

AVOKATI I POPULLIT ME NISMË KONKRETË

# KUFIZIMET LIGJORE DËMTOJNË FËMIJËT



Ministritë së Shëndetësisë.

Në arsyetimin shtesë të cilin e kanë dhënë shërbimet e Fondit për sigurim shëndetësor, thuhet se veprimi i tyre mbështet në dispozitat e Rregullores për të drejtat e pajisjeve ortopedike. Ndaj këtij qëndrimi të drejtuesve të Fondit, ka reaguar Ombudsmani i cili ka konstatuar se kufizimet ligjore që ekzistojnë në Ligjin për sigurim shëndetësor dhe Rregulloren e Fondit, paraqesin shkelje të të drejtave të fëmijëve që kanë nevojë për pajisje ortopedike.

Shkelje të tilla Avokati i Populli, si institucion për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të njeriut vazhdimisht i ka konstatuar, duke filluar nga viti 2016 e kënde. Një prej shumë rasteve të ngjashme siç thonë nga zyra e Ombudsmanit, ka ndodhur pikërisht para dy viteve, kur një qytetar gjatë procesit të punës ka pësuar sulm në kokë (në muajin e tretë të punës). Në këtë mënyrë, sqarohet nga Ombudsmani, ai ka hapur procedurë për pushim mjekësor. Dispozitat ligjore në këto rrethana parashohin që deri në 30 ditë pagesën e mbulon punëdhënë-

si, kurse mbi 30 ditë Fondi.

"Praktika e vërtetoi se të drejtën e mbulimit të pagës ky person nuk ka arritur ta shfrytëzojë, pasi që punëdhënësi këmbëngulte se ai vepron sipas ligjit, përderisa fondit përgjigje se nuk mundet t'i mbulon harxhimet e tija pasi që i njëjti nuk ka qenë i siguruar 6 muaj në vazhdimësi. Më të vërtet kjo dispozitë është tejet e palogjikshme dhe diskriminuese dhe për këtë arsye insistojmë në shfuqizimin e saj në procedurën e ndryshimeve ligjore që duhet të ndodhin së shpejti", thonë nga zyra e Avokatit të Popullit.

Me qëllim përmirësimin e sistemit social në vend nga zyra e Ombudsmanit, kanë theksuar se është koha e fundit që Qendrat për punë social t'i zbatojnë siç duhet detyrat e tyre. Dalja në terren dhe njoftimi me gjendjen reale të shoqërisë, ku vende-vende ekzistojnë familje të cilat jetojnë pa kushtet elementare sipas Ombudsmanit duhet të jenë prioritet i këtyre qendrave që funksionon nën Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale.

## Aksidentohen dy persona me motoçikletë

Tetovë, 6 korrik - Të enjten rreth 15.00, në udhëkryqin në mes të rrugëve "Blagoja Toska" dhe "JNA" ka ndodhur aksident trafiku, në të cilin pjesëmarrës kanë qenë vetura e tipit "Golf" me targa të Tetovës, e drejtuar nga 32 vjeçarja A.I. nga fshati Sedllarcë e Epërme dhe motoçikleta e tipit "Pezho" gjithashtu me targa të Tetovës, e drejtuar nga 23 vjeçari B.A. nga fshati Poroj. Motoçiklisti B.A. dhe bashkudhëtarit i tij A.A., 29-vjeç nga fshati Poroj, kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në Spitalin klinik të Tetovës. Janë kryer hetimet në vendin e ngjarjes dhe punohet për zbulimin e shkakut të aksidentit, rrethanave dhe të gjitha detajeve në veçanti për ndodhjen e këtij aksidenti. (U.H)

Sipas numrit një të MATO-s, Ajdovan Ademovski, investimet turke në Maqedoni kanë arritur në 1.8 miliardë dollarë, ndërsa këmbimi tregtar apo eksporti dhe importi midis dy shteteve ka arritur në 400 milionë euro, derisa tendenca e të dy qeverive është që në të ardhmen - këmbimi tregtar të rritet në së paku 1 miliardë dollarë

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 6 korrik - Investitorët turq janë të mirëseardhur në Maqedoni, pasi dukshëm është përmirësuar situata politike, shteti është para anëtarësimit në NATO dhe hapjes së negociatave për anëtarësim në BE, ofrohen kushte edhe për 30 më të ulëta për prodhimtarinë në raport me shtetet e tjera. Gjithashtu marrëdhëniet më shumë se në nivel politik, duhet të pasqyrohen edhe në rritjen e investimeve turke dhe tregtinë e ndërsjellë midis dy shteteve. Kjo u theksua ndër të tjerash para gazetarëve ekonomik turq në takim qe e organizoi Oda Ekonomike e Maqedonisë dhe ajo e Turqisë - MATO. Sipas numrit një të MATO-s, Ajdovan Ademovski, investimet turke në Maqedoni kanë arritur në 1.8 miliardë dollarë, ndërsa këmbimi tregtar apo eksporti dhe importi midis dy shteteve ka arritur në 400 milionë euro, derisa tendenca e të dy qeverive është që në të ardhmen - këmbimi tregtar të rritet në së paku 1 miliardë dollarë.

INVESTITORËT TURQ TË MIRËSEARDHUR

# MARRËDHËNIET POLITIKE TË NDJEKIN ATO EKONOMIKE



Gjithashtu, tha Ademovski, Turqia renditet në vendin e gjashtë ndër investitorët më të mëdhenj në vend dhe në vendin e tetë lidhur me tregtinë e jashtme të Maqedonisë.

"Politikanët në të dyja shtetet duhet të angazhohen që marrëdhëniet shumë të mira midis dy shteteve të pasqyrohen edhe në marrëdhëniet e ndërsjella ekonomike. Investitorët turq në Maqedoni nuk kanë qasje vetëm në një treg prej dy milionë konsumatorë, por përmes marrëveshjeve bilaterale që ka nënshkruar Maqedonia, ato kanë qasje në një treg prej 500 mi-

lionë konsumatorë. Gjithashtu, Ek-sim Banka e Turqisë ka vendosur në dispozicion një fond prej 400 milionë dollarë, andaj ekziston mundësia që së paku - një pjesë e këtyre mjeteve investohen në Maqedoni", u shpreh Ademovski.

Në ndërkohë, nga Ministria e Ekonomisë së Maqedonisë thonë se me hapjen e perspektivave euroatlantike të vendit, si dhe me masat e volitshme për investitorët, pritet që ekonomia vendore të jetë edhe më tërheqëse për investitorët turq.

"Maqedonia është shtet i vogël,

por hapëron para me hapa të fuqishme. Maqedonia pas disa vitesh shndërrohet në shtet stabil, në të cilën çdo investitorë mund të vijë për të realizuar projektet e tij. Gati një vit punojmë në planin e ri për tërheqjen e investimeve, ndërsa kemi sajuar edhe planin për rritje ekonomike që parashikon mundësi të barabarta për investitorët vendor dhe të huaj", tha ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi.

Në takimin me gazetaret turq që janë për vizitë treditore në Maqedoni, foli edhe ministri pa portofol Adnan Qahil. "Maqedonia paraqet

lokacion të vërtetë për investitorët turq. Vendi ofron mundësi shumë të mira për investime, edhe atë më së shumti në zonat e lira ekonomike, ku tatimet e ndryshme janë zero, ndërsa për shkak të kushteve të tilla, prodhimtaria në vend është 30 për qind më e lirë në raport me shtetet e tjera", theksoi Qahil. Ndryshe, aktualisht nga anëtarë të MATO-s, "City Plaza Holding" është pronare edhe e hotelin "Stone Bridge", po ndërton hotelin Hilton në Shkup i vlefshëm 50 milionë dollarë, ndërsa kompania "Limak" në hapësirën afër kompleksit Ramstor dhe stacionit të vjetër të hekurudhës në Shkup po ndërton një kompleks me katër ndërtesa nga 20 katëshe ku do të ketë apartamente banimi, hotel, qendër tregtare dhe më shumë objekte të tjera. Limak në bazë të marrëveshjes do të ndërtojë edhe tunelin nëntokësor me gjashtë korsi në gjatësi prej 800 metrash në bulevardin jugor që do të zbusë problemin e tollovide në trafikun e Shkupit. Flitet gjithashtu se në rast të shitjes eventuale së kompanisë së Telekomit të Maqedonisë, blerës serioz potencial mund të jetë gjiganti turk i telekomunikacionit "TurkCell".

INCIDENTI NË REÇICË TË VOGËL

## Nga 4 muaj burg për katër të akuzuarit e Kumanovës

Për të akuzuarin Lulzim Biti, gjykata ka marrë vendim që pas vuajtjes së dënimit, i njëjti të depërtohet në Shqipëri dhe i është shqiptuar ndalesë prej 5 vitesh hyrje në Maqedoni



### ZBARDHET VJEDHJE E MARKETIT "OAZA", ARRESTOHEN 4 PERSONA

Zbardhet vjedhje e marketit "Oaza" në Tetovë që ndodhi më 17 qershor të këtij viti. Sipas policisë së Tetovës, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë tërësisht ka zbardhur vjedhjen duke arrestuar mbrëmë katër persona nga Tetova, të cilët dyshohen se kanë kryer vjedhjen në marketin në rrugën "Kiro Ristovski Dërnç". Nga policia

njoftuan se katër personat, ndaj tre të punësuarve me kërcënim me thikë dhe të maskuar kanë marrë 175 mijë denarë. Gjatë ditës së djeshme dhe sotme janë arrestuar katër persona në mesin e tyre edhe një 17 vjeçar edhe atë. B.Z 20 vjeçar, R.S 19 vjeçar dhe A.B 20 vjeçar, që të gjithë nga Tetova.

- një person është vranë dhe një tjetër ka marrë plagë të rënda me pasojë të rënda. Gjatë sjelljes së vendimit janë marrë parasysh edhe rrethanat lehtësuese ndaj të aku-

zuarve, të cilët janë të angazhuar në punë në institucione, kanë fëmijë dhe përkujdesen për familjet e tyre. Në ndërkohë, për të akuzuarin Lulzim Biti, gjykata ka marrë vendim

që pas vuajtjes së dënimit, i njëjti të depërtohet në Shqipëri dhe i është shqiptuar ndalesë prej 5 vitesh hyrje në Maqedoni. Të akuzuarve do t'ju llogaritet edhe koha sa kanë qenë

Tetovë, 6 korrik - Gjykata Themelore e Tetovës ka shpallur fajtor Ridvan Dervishin, Sabit Rexhepin, Halil Kamberin - që të katër nga Kumanova dhe Lulzim Biti nga Shqipëria për vepër penale pjesëmarrje në rrahje. Vendimi është lexuar nga ana e gjykatësit Betim Jahja ku të pranishëm ishin tre të akuzuarit, ndërsa mungonte Lulzim Biti, i cili ndodhet në paraburgim.

Gjykatësi theksoi se më 5 prill të këtij viti, të katër të akuzuarit kanë marrë pjesë në rrahje mes dy grupeve, ku pas një zënke verbale në Reçicë të Vogël, ata kanë filluar edhe përlëshjen me përdorimin e sende të forta, ndërsa gjatë kësaj përlëshje

në paraburgim. Sipas të dhënave, të dënuarit kanë qëndruar në paraburgim diku rreth 50 ditë. Avokati Miralem Asani është shprehur se dënimi është rigoroz dhe në koordinim me të dënuarit, do të vendoset nëse do të ankimohet ky vendim. "Gjykata vendosi që të dënojë me nga katër muaj të akuzuarit, dhe mendojmë se është një vendim rigoroz, por ne do të konsultohemi edhe me klientët se a do të ankimohet vendimin dhe kërkesa jonë është që ata të dënohen me kusht", deklaroi avokati Asani.

Në incidentin e armatosur të këtij viti jetën e humbi Naip Rexhepi, ndërsa u plagos Florim Misini. Seanca e radhës për incidentin në Reçicë të Vogël është caktuar për më 11 korrik. Prokuroria e Tetovës, paraprakisht kishte ngritur akuzë kundër 13 personave për pjesëmarrje në incidentin e armatosur që kishte ndodhur jo larg selisë së BDI-së. Sipas informacioneve që qarkullojnë në opinion, incidenti ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve për drejtimin e Degës së BDI-së në Kumanovë. (U.H)

"BB 2018" PUBLIKON HULUMTIMIN PËR MIRËQENIEN E RAJONIT



Ende është evident besimi i ulët në institucionet politike dhe apatia e përhapur mes qytetarëve, ndërsa shumica e të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë të gatshëm të përfshihen në procesin e sjelljes së vendimeve qeveritare. Përmirësime shënohen vetëm në disponimin rajonal për integrim në BE

# TË SIGURT NË PUNË, PAK BESIM TE INSTITUCIONET

qind e kompanive të Maqedonisë konsiderojnë se cilësia e bashkëpunimit rajonal është shumë e rëndësishme për përparimin e biznesit të tyre, ndërkohë që 40 për qind e qytetarëve të anketuar konsiderojnë se Qeveria më së shpeshti në mënyrë efektive lufton kundër korrupsionit. Mbi 35 për qind e të anketuarve nga Maqedonia janë proaktiv në marrjen e informatave për mundësitë në vendet e huaja. Ky është edicioni i katërt i Barometrit Ballkanik, hulumtim që zbatohet në suaza të Këshilli për bashkëpunim rajonal, ndërsa në të cilën përpunohen të dhënat për pritjet dhe aspiratat e popullatës në rajon dhe të bashkësisë së biznesit për tema të lidhura me jetën dhe punën, trendet socio-ekonomike dhe politike, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe integrimi evropian. Hulumtimi i përgjithshëm tregon se kënaqësia e opinionit në rajonin e gjashtë vendeve, edhe pse nën mesataren, megjithatë shënon përmirësim.

Qytetarët në rajon janë shumë më pozitiv për të ardhmen, se sa ndaj gjendjes së tanishme. Papunësia ende është problemi më i madh me të cilin përballlet rajoni, ka sinjale për përmirësim të

gjendjes së tregjeve të punës, që vlerësohet si trend pozitiv në drejtim të ndalimit të derdhjes së mendjeve. Edhe derisa përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe rritja e papunësisë pozitivisht ndikojnë ndaj ndjenjës së qytetarëve, situata politike ende i tërheq teposhtë perceptimet. Ende është evident besimi i ulët në institucionet politike dhe apatia e përhapur mes qytetarëve, ndërsa shumica e të anketuarve janë përgjigjur se nuk janë të gatshëm të përfshihen në procesin e sjelljes së vendimeve qeveritare. Përmirësime shënohen në disponimin rajonal për integrim në BE. Indeksi publik i kënaqësisë shënon rritje prej shtatë për qind, prej 35 në vitin 2015 në 42 në vitin

2018, ndërsa ekonomistët rajonal pozitivisht e vlerësojnë si gjendjen e tanishme, ashtu edhe progresin e mëtutjeshëm. Përqindja e ekonomistëve të kënaqur është 62 për qind në krahasim me vitin e kaluar 47 për qind në vitin 2015. 56 për qind e qytetarëve janë të pakënaqur nga gjendja ekonomike momentale, derisa kënaqësi kanë shprehur 14 për qind, që është për pesë për qind më shumë se në vitin 2015. Shumica, përkatësisht 59 për qind e të anketuarve konsiderojnë se gjinia nuk luan rol gjatë punësimit, por megjithatë 27 për qind preferojnë të punësojnë burra, ndërsa vetëm tetë për qind gra.

69 për qind e qytetarëve të Ballkanit gjendjen e tyre socio-eko-

nomike e konsiderojnë si mesatare, 47 për qind nuk kanë mundur të lejojnë vikend jashtë shtëpisë në 12 muajt e fundit (në vitin 2015 kjo përqindje ka arritur 53), 19 për qind nuk kanë mundur në mënyrë adekuate ta ngrohin shtëpinë e tyre (në vitin 2015 ka qenë 22 për qind), 21 për qind nuk kanë mundur t'i paguajnë shpenzimet ose fakturat (në vitin 2015 përqindja ka qenë 29), ndërsa 14 për qind nuk kanë mundur të lejojnë shpenzime bazë, si veshmbathje dhe ushqim (në vitin 2015 ka qenë 21 për qind).

Ndryshe, hulumtimi është zbatuar kah fundi i vitit të kaluar nga GfK në shembullin e 6000 qytetarëve dhe 1200 kompanive.

## PARLAMENTIT MË SË PAKU I BESOHET

Shënohet mungesë e jashtëzakonshme e besimit në institucione. Parlamenti është institucion, i cili gëzon besim më të vogël 28 për qind, ndërsa besim më të madh ka Avokati i Popullit 37 për qind. Ryshfetet janë dominuese në shëndetësi për 15 për qind e të anketuarve, gjashtë për qind konsiderojnë se ajo ndodh në polici, ndërsa katër për qind në gjyqësi. Më të korrumpuar sipas të anketuarve janë partitë politike 79 për qind, pastaj vijoje të punësuarit në sistemin gjyqësor për të cilët janë përcaktuar

75 për qind, për doganë dhe shëndetësi janë përcaktuar 74 për qind, 63 për qind janë përcaktuar për arsim, ndërsa 42 për qind për të korrumpuar i konsiderojnë liderët fetar. Shtatëdhjetë për qind e qytetarëve ballkanik konsiderojnë se qeveritë e tyre nuk ballafaqohen në mënyrë efikase me korrupsionin. Kënaqësia e gjendjes së tërësishme të sigurisë është nën mesataren. Në shkallë prej një deri në pesë për qind, këtë vit kënaqësia e sigurisë arrin 2.6, ndërsa vitin e kaluar ishte 2.5.

## Pikëpagesat sjellin 55 milionë denarë më shumë

Shkup, 6 korrik - Ndërmarrja publike për rrugë shtetërore (NPRRSH) në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2018 ka realizuar të ardhura të rritura nga taksat rrugore për 55 milionë denarë ose 5.3 për qind më shumë se në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Siç informoi drejtori i NP "Rrugët shtetërore", Zoran Kitanov në konferencë për shtyp në Qeveri, kjo ka të bëjë me intensitetin e rritur të komunikacionit dhe organizimin më të mirë të pikëpagesave rrugore. "Për rreth dhjetë ditë pres të fillojë të funksionojë pagesa elektronike e taksave rrugore dhe atë së pari në Korridorin 10. Në këtë moment janë të gatshme taksat rrugore në Romanovc, Sopot dhe Otovicë. Bëhen

përprojekte edhe për pikëpagesat në Kavadar, por me sendërtimin e softuerit ekzistues. Nga shtatori do të punohet edhe në pikëpagesat në Korridorin 8", tha Kitanov. Ai informoi edhe se NP për rrugë shtetërore në tremujorin e dytë të vitit ka realizuar investime me vlerë të përgjithshme prej rreth 2.2 milionë denarë, respektivisht 36 milionë euro, që është për 9.8 milionë euro më shumë se në krahasim me periudhën e njëjtë vitin e kaluar, respektivisht rritja është për 37 për qind. Ndryshe, me rreth 20 milionë euro mjete buxhetore dhe me mjete të NPRRSH-së, ai tha se veçmë punohet në rehabilitimin e rrugëve shtetërore në gjatësi prej 230 kilometrave. (mia)

## 720 mijë dollarë për cilësinë e ajrit në Shkup

Shkup, 6 korrik - Kryetari i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov dhe përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së, Luiza Uinton nënshkruan marrëveshje për bashkëpunim për realizimin e projektit "Shkup rezistues: qëndrueshmëri më e mirë dhe inovacione për ballafaqim me ndryshimet klimatike", që do të kushtojë 720.000 dollarë, ndërsa do të zbatohet 18 muaj. "Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje Qyteti i Shkupit obligohet të sigurojë mjedis më të mirë jetësor, ta mbrojmë natyrën dhe biodiversitetin në qytet dhe në rrethinë, t'i përmirësojmë kushtet për jetë, të ndërmarrim aktivitete për ballafaqim me ndryshimet klimatike dhe t'i këmij qytetarët në

marrjen e vendimeve dhe duke i ndjekur nevojat e tyre të sigurojmë jetë më të mirë për të gjithë", theksoi Shilegov. Uinton deklaroi se marrëveshja do të thotë vazhdimi i një partneriteti shumë produktiv, që UNDP tashmë disa vjet e zbaton në Qytetin e Shkupit. Përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së tha se aktivitetet që do të zbatohen me fillimin e këtij projekti drejtpërdrejt janë të fokusuar në punën me qytetarët dhe të punës me komunitet me qëllim të rritet vetëdija e tyre dhe të ulet shfrytëzimi i drurit për ngrohje, veçanërisht të atyre praktikave jo të shëndosha për ngrohje siç janë ngrohja me mbeturina dhe plastika. (mia)

“Ju falënderoj pa masë Juve kongresist Engël, jo vetëm për iniciativën që të më dhuroni këtë flamur, që në nderim timin u valëvit në Capitol Hill, por edhe për angazhimin tuaj personal prej dekadash, duke dhënë kontribut të paçmueshëm për zgjidhjen e çështjes shqiptare si dhe për demokratizimin e rajonit të Ballkanit në përgjithësi”, tha Destani, një nga figurat më në zë të botës së biznesit shqiptar

Nju Jork, 6 korrik - Në një ceremoni simbolike, të zhvilluar në zyrën e tij, kongresisti Eliot Engel i dorëzoi zyrtarisht biznesmenit dhe filantropistit të shquar Lazim Destani, flamurin amerikan që është valëvitur në 4 Korrik, mbi ndërtesën e Kongresit Amerikan. “Ky flamur u valëvit për t’ju nderuar juve në 4 Korrik, miku im”, i tha kongresisti Engel duke ia dorëzuar në mënyrë ceremonial një ditë më pas flamurin, ndërsa e falënderoi që Festën e Amerikës e kishin festuar së bashku në Nju Jork. Engel i lexoi edhe përmbajtjen e dokumentit zyrtar që shoqëron flamurin e palosur në mënyrë ceremoniale në fund të ditës së valëvitjes, nga oficerë të Ushtrisë Amerikane.

“Ky është një çmim dhe vlerësim që na nderon të gjithë ne shqiptarëve!

Për mua personalisht ky është një nga nderet më të mëdha që kam përjetuar deri më tani. Është i këtilë sepse e pranoj nga shteti Amerikan, nga shteti i cili historikisht na ka mbështetur dhe me të cilin kemi lidhje të forta miqësore”, thanë fjalën e tij biznesmeni dhe filantropi shqiptar me emër, Lazim Destani. Është një traditë e bukur amerikane që flamujt, të cilët valëviten mbi ndërtesën e famshme të Kongresit, të njohur ndryshe si Capitol Hill (Kodra e Kapitolit), të përdoren vetëm një herë dhe të ruhen si simbole të vjera amerikane. Ata ruhen për t’u dhuruar miqve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, apo figurave të shquara të fushave të ndryshme. Shpesh, si në rastin e filantropistit të shquar shqiptar, flamurit porositet paraprakisht, në mënyrë që të dihet se për kë valëvitet.

Në këtë rast, ndërmjetës për të nderuar zotin Destani ishte kongresisti Eliot Engel. Themeluesi dhe bashkëdrejtuesi i Kaukusit të Interesave Shqiptare në Kongresin Amerikan dhe një nga miqtë më të mëdhenj të botës shqiptare në këto 30 vitet e fundit, Engel ka ndërhyrë edhe në raste të tjera për

ME RASTIN E 4 KORRIKUT

# FLAMURI AMERIKAN VALËVITET MBI CAPITOL HILL PËR NDER TË DESTANIT



nderime me flamur.

“Unë jam shumë krenar për miqësinë mes popullit shqiptar dhe popullit amerikan. Kemi një diasporë të mrekullueshme shqiptare, e përqendruar sidomos në Nju Jork, por e shtrirë kudo dhe unë kam pasur rastin t’i vizitoj në Detroit, Chicago dhe Boston”, tha Engel, i cili e falënderoi zotin Destani

për miqësinë e tij. Kongresisti kujtoi kohën kur vizitoi Ballkanin dhe shkoi nga Kosova në Tetovë, Maqedoni. “Ju na pritët me bujari dhe krahe hapur dhe u jam mirënjohës”. Engel foli edhe për rrugën e vështirë drejt lirisë që i ishte dashur të bënin shqiptarët, në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni etj.

Edhe Lazim Destani foli me të njëjtën frymë. “Unë e çmoj lart këtë miqësi mes dy popujve tanë dhe do vazhdojmë ta forcojmë gjithnjë e më shumë duke mbetur përgjithmonë miq të ngushtë mes vete dhe partnerë besnik të idealeve të përbashkëta. Ju falënderoj pa masë Juve kongresist Engël, jo vetëm për iniciativën që të më dhuroni këtë flamur, që në nderim timin u valëvit në Capitol Hill, por edhe për angazhimin tuaj personal prej dekadash, duke dhënë kontribut të paçmueshëm për zgjidhjen e çështjes shqiptare si dhe për demokratizimin e rajonit të Ballkanit në përgjithësi”, tha Destani, një nga figurat më në zë të botës së biznesit shqiptar. “Ju jeni dhe përgjithmonë do të mbeteni një ndër figurat më emblematike dhe historike për ne shqiptarët si edhe për botën demokratike të rajonit tonë”. Disa vjet më parë, flamuri amerikan u valëvit në majën e selisë së Kongresit Amerikan për nder të shkrimtarit Ismail Kadare. Në 1996, kur në mes të periudhës

së zezë të diktaturës së Millosheviqit, kongresisti Engel siguroi hapjen e Zyrës Amerikane në Prishtinë, ai solli me vete një flamur të tillë që ishte valëvitur mbi Capitol Hill. Është një nder akoma më i madh kur bëhet fjalë për një flamur të valëvitur në datën 4 Korrik, festës së madhe kombëtare të Pavarësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Vendi që siguroi pavarësinë e Shqipërisë dhe të Kosovës e meriton t’ia festosh festën e vet të pavarësisë. Aq më bukur kur në një ditë si 4 Korriku nderohet edhe një figurë shqiptare.

Lazim Destani u bë një nga emrat më të njohur të biznesit në Gjermani, fillimisht me “Sharr Tourist”, e pastaj me firmën e tij ndërkombëtare Ecolog. Veprimtaria e tij e shtrirë në mbarë globin përfshiu edhe programe transporti dhe furnizimi për trupat e NATO-s në disa vende. Duke dashur të bëjë më shumë për shqiptarët dhe komunitetin ku u lind, ai zgjeroi biznesin e tij edhe në Tetovë, investoi në disa aspekte të shoqërisë shqiptare, dhe ka shërbyer e shërben si një shembull model i sipërmarrësit shqiptarë në atdhe dhe në diasporë.

Ai është edhe pronar i klubit të futbollit “Shkëndija” me të cilin ka arritur suksese të mëdha në kampionatin vendas e së fundi me sfida të forta ndërkombëtare. Lazim Destani është i njohur edhe në komunitetin shqiptaro-amerikan, si pjesëmarrës i rregullt i darkave vjetore të Këshillit Kombëtar Shqiptaro Amerikan, ku është njohur edhe me kongresistit Engel. Disa vite më parë, gjatë një vizite në Ballkan, i shoqëruar nga aktivisti Harry Bajraktari dhe botuesi i gazetës “Illyria”, Vehbi Bajrami, kongresisti Engel ndaloi në Tetovë për t’u konsultuar me zotin Lazim Destani, të cilin e përgëzoi për nismat e tij për përparimin e shoqërisë shqiptare në Maqedoni. Zoti Destani shtroi një drekë për miqtë nga SHBA. Lidhjet mes tyre kanë mbetur të forta edhe sot e kësaj dite dhe ishin të dukshme në ceremoninë e mbajtur në Zyrën e Kongresistit Engel.

Një vit më parë, Engel kishte marrë pjesë në një festim të 4 Korrikut në Kosovë, të organizuar nga Harry Bajraktari. Këtë vit, ishte Engel që e organizoi në Nju Jork festën për Ditën e Pavarësisë së Amerikës. Kongresisti i njohur dhe miku i tij nga Europa, Lazim Destani u ndanë me urimin që një nga festat e ardhshme të 4 Korrikut ta festojnë në Tetovë, mes shqiptarëve të Maqedonisë.





## Konkurs për shpërndarjen e 53 banesave sociale

Shkup, 6 korrik - Ministria e Transportit dhe Lidhjes (MTL) ka publikuar konkursin për shpërndarjen e 53 banesave sociale, ku 43 banesa janë në Koçan dhe 10 në Makedonski Brod. Në konkursin, që është hapur deri në 6 gusht, shpërndahen banesa me sipërfaqe prej 35 deri në 45 metra katror, të ndërtuara përmes programit për ndërtimin dhe mbajtjen e banesave në pronësi të shtetit. Për banesat do të mund të aplikojnë shtatë kategori të familjeve sociale, siç janë fëmijë pa prindër apo përkujdesje prindërore mbi 18 vjeç që kanë qenë nën përkujdesje të institucioneve dhe formave të tjera dhe shfrytëzues të ndihmës sociale apo ndihmës së përhershme në para dhe persona të prekur nga fatkeqësi elementare pa dallim të statusit juridik në vendbanimet e tyre. "Banesat sociale do të ndahen në procedurë transparente përmes metodologjisë së pikave që do kenë kandidatët. Përparësi gjatë procedurës do të kenë fëmijët pa prindër apo përkujdesje prindërore- persona nën 18 vjeç që deri në këto vite kanë qenë nën përkujdesje të institucioneve dhe formave të tjera të përkujdesit për fëmijë pa prindër", ka thënë në pres konferencën e sotme, ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugarevski. Ndryshe, gjatë vitit 2019 dhe 2020 planifikohet ndërtimi i 355 banesave sociale në Shkup, Gjevgjeli, Kumanovë, Dibër, Veles dhe Tetovë. Përmes programit në fjalë deri tani janë ndërtuar 731 banesa në 15 komuna.

(mia)

Projekti "CityTree" pritej se do të ndihmonte në luftën kundër ndotjes së ajrit në Tetovë, me mundësi që projekti në fjalë të implementohej edhe në qytetet tjera. Megjithatë, tani e njëjta është tharë tërësisht

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 6 korrik - Kopshti vertikal për pastrimin e ajrit i quajtur ndryshe "City Tree" ose "Pema e qytetit", tashmë një kohë të gjatë është jashtë funksionit. I vendosur para një viti në qendër të Tetovës si donacion nga Ambasada e Gjermanisë, "Pema e Qytetit" tashmë nuk ka asnjë funksion dhe është tharë tërësisht. Para gjashtë muajve kishte dëmtime të pjesërisht dhe të njëjtat u sanuan, por tashmë nuk kryen asnjë funksion. Këtë e kanë konfirmuar edhe nga ana e Komunes së Tetovës.

"Para gjashtë muajve, ne si komunës së bashku me shoqatën 'Eko Svest', kemi intervenuar në atë pjesë që ishte tharë dhe sérish u vendos në funksion", tha Armend Fazliu, zëdhënës i Komunes së Tetovës. Shkak që "Pema e Qytetit" nuk funksionin është mirëmbajtja në kohë, dëmtimi dhe kushtet klimatike, pohojnë nga Komuna e Tetovës.

"Arsyet që është jashtë funksionit janë kushtet klimatike dhe faktori njeri, sepse ata dëmtohen,

"CITY FREE" NË TETOVË JASHTË FUNKSIONIT

# THAHET PEMA QË PASTRON AJRIN!



vetëm disa orë në vit. Konstruksioni përmban dhe sensore për të mbledhur të dhëna të rëndësishme për mjedisin jetësor dhe klimën me qëllim për të rregulluar dhe kontrolluar të gjithë strukturën dhe për të siguruar mbijetesën e bimëve.

Projekti "CityTree" është theksuar më herët se do të ndihmojë në luftën kundër ndotjes së ajrit në Tetovë, me mundësinë që projekti në fjalë të implementohet edhe në qytetet tjera. Në të njëjtën kohë, ajo do të shërbejë për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të filluar diskutimet mbi politikën dhe praktikën për të zbutur problemet e ndotjes së ajrit.

"City Tree" ose në përkthimin tekstual "Pema e Qytetit", është një strukturë vertikale e myshqeve, me një lartësi prej 4 metrash, një gjerësi prej 3 metrash dhe një thellësi prej 60 centimetra. "City Tree", i cili është instaluar në pjesën qendrore të qytetit, paraqet një strukturë vertikale të bimëve, të cilët bëjnë thithjen e pluhurit dhe kanë aftësinë të neutralizojnë 240 ton dyoksid karbon në vit. I njëjti në Tetovë është vendosur më 21 mars të vitit të kaluar.

vidhen apo hidhen mbeturina të ndryshme dhe kjo i shkakton probleme gjatë procesit të ujitjes", deklaroi Fazliu. Nga komuna njoftuan se pritet që shumë shpejt, pema vertikale të riparohet tërësisht dhe të fillojë të funksionojë normalisht edhe pse vitin e kaluar akuzat ishin se autoritetet komunale nuk janë kujdesur për mirëmbajtjen e së njëjtës dhe prandaj ka ndodhur havaria. Problem në vete është edhe vjedhja e të njëjtëve

nga qytetarë të pandërgjegjshëm, të cilët i marrin për përdorim në shtëpitë e tyre. Përndryshe, ky filtër bimor kompenson ndotjen e 417 automjeteve në nivel vjetor dhe mund të përshtatet në çdo mjedis jetësor. "City Tree" ka efektin e njëjtë sikur të ishin mbjellë 275 drunj në Tetovë. Falë paneleve diellore dhe sistemit për të absorbuar ujin e shiut, kjo strukturë është praktike dhe rezistente, ndërsa e njëjta ka nevojë servisimi për

## Kopshti i ri në Kërçovë nis punën nga shtatori

Kërçovë, 6 korrik - Në shtator në Kërçovë do të lëshohet në përdorim kopshti i ndërtuar me mjetet e Agjencisë Turke për bashkëpunim dhe koordinim "TIKA". Kopshti i ri është me kapacitet për 120 fëmijë

deri në moshën gjashtëvjeçare. Tërësisht është pajisur dhe së shpejti duhet vetëm të zgjidhet çështja e personelit dhe kopshti të lëshohet në përdorim. Karakteristike është ajo që edhe ky kopsht fëmijë-

sh do të jetë pjesë e kopshtit më të vjetër të fëmijëve në Kërçovë "Olga Miceska" dhe të tre kopshtet në qytet do të funksionojnë me një drejtor. "Hapja e kopshtit të ri të fëmijëve në një pjesë të mirë do të zgjidhë

problemin e mungesës së vendeve të lira në kopshtet ekzistuese, ndërsa të drejtën e punësimit të parë do të gjejnë një pjesë e personave, kryesisht femra", thotë Sadik Ahmeti, drejtor i kopshtit në Kërçovë.

AKADEMI PËRKUJTIMORE PËR 5-VJETORIN E VDEKJES SË ALITIT

## Historia e re e shtetit, e mangët pa Abdurrahman Alitin

Shkup, 6 korrik - Me rastin e 5 vjetorit të ndarjes nga jeta e Abdurrahman Alitit, në fjalimin e tij të enjten mbrëma, kreu i BDI-së, Ali Ahmeti, tha se Aliti do të mbetet figura ndër figurat dhe jo vetëm që do të kujtohet por edhe do të shkruhet, gjithashtu edhe historia e re e këtij shteti do të ishte e mangët pa figurën dhe emrin e tij.

"Është nga të parët që ngriti zërin dhe alarmoi opinionin vendor dhe atë ndërkombëtar se pikërisht ndryshimi i Kushtetutës është gjenerator i krizës dhe ashtu ndodhi pasi që ndryshimi i Ku-

shtetutës në 1974 solli krizën dhe hapi një front që kishte mundur të parandalohet po qe se dëgjohej filozofia dhe alarmi që bëri analisti i mençuri i urti, Abdurrahman Aliti", u shpreh kryetari i BDI-së, Ahmeti. Ahmeti para të pranishmëve tha se ai e ka njohur Alitin nga viti 2001 deri në kohën kur pushon së ekzistuar fizikisht figura e tij.

"Njeri i guximit i lartëpamësisë, ai guximshëm hyri pranë brigadës në Karadak dhe u ul me të gjithë drejtuesit të cilët i inkurajoi për të vazhduar punën deri në aktin final. Njeri i durimit, njeri që

duronte aq shumë sa që për mua ishte një mësim. I urtë dhe i vendosur në veprimet dhe në përcaktimet që i kishte. Asnjëherë nuk e pashë të hidhëruar dhe asnjëherë s'kemi qenë oponentë, por miq e bashkëpunëtorë në të gjitha fushat e veprimit nga viti 2001 e këndej," thekson kryetari i integristëve Ahmeti. Para të pranishmëve fjalë rasti pati e shoqja e të ndjerit, Aburrahman Aliti, Gjylimsere Aliti, ndërkaq në emër të drejtorit të Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore të Kulturës së Shqiptarëve në Maqedoni, me një fjalim u paraqiti Besnik Rahmeti. (U.H)



# Të (mos) jesh Zaev

Nga  
Daut DAUTI



Tregojnë një anekdotë për djalin e Lubço Georgievskit, kur kishte qenë 3-4 vjeç, posa ishte zgjedhur i ati kryeministër. E kishin pyetur çka punon babai, ai ishte përgjigjur: "Branko Cërvenkovski". Sepse babai i Lavit posa ishte bërë "Branko Cërvenkovski dhe ai si një i mitur kishte barazuar kryeministrin me personin që e kishte ushtruar atë post. Kanë kaluar dy dekada nga kjo anekdotë, sepse sot një fytyrë krejtësisht tjetër, Zoran Zaevi, është bërë "Branko" (e trashëgoi si kryetar partie), edhe "Gruevski" (e trashëgoi si kryeministër), dy poste kyç në shtet që shumëkush mund t'i ëndërojë. Në këto rrethana, tash është krye rivali i tij, Hristijan Mickovski, ai që ëndërron të bëhet "Zaev" ...

Në botën demokratike me traditë, motivi për të ardhur në pushtet është më ndryshe nga perceptimi në vendet në tranzicion. Atje një Donald Tramp, ose kushdoqoftë, vjen në pushtet si njeri i suksesit, sa për të bërë nam, aq edhe për t'i ndihmuar shoqërisë. Në vendet si Shqipëria, Maqedonia, Serbia, Rumania, Bullgaria..., që kishin dalë nga komunizmi, politikës i rreken idealistë që mendojnë se do ta ndryshojnë botën, por dhe profiterë, të cilët i lyhen arkës së shtetit dhe duke u bërë biznesmenë të mëdhenj brenda nate... Shikuar nga ky këndvështrim, ardhja e Zaevit në pushtet duhej të ishte me analogjinë e sipërme të Dobald Trampit, e jo të vendeve në tranzicion. Ai në politikë u kyçsi një biznesmen i suksesshëm, duke u bërë një nga figurat

më të suksesshme "alternative" të LSDM-së (alternative, ngase vite me radhë ai nuk ishte në udhëheqësinë e ngushtë të LSDM-së). Madje edhe në vitet e inferioritet më të madh të LSDM-së kundrejt të VMRO-së së Gruevskit, Zaevi krijoi bastionin e papushtueshëm të Strumicës si kryetar komune. Pra, krahas biznesit, i suksesshëm edhe në politikë. Në këtë mënyrë, me aureolën e një të suksesshmi, anise "provincialist", do të gjendej nga ish-lideri partiak për ta futur në zjarr kundër të pamposhturit Gruevski, që ta rimëkëmbë partinë dhe ta kthejë në pushtet... Së pari, në vitin 2008, si "kryetar i përkohshëm" i LSDM-së, një vit ia ruajti vendin e liderit partiak Cërvenkovskit gjera ky të jetë në funksionin e kryetarit të shtetit dhe së dyti, përfundimisht, pasi "lideri historik" tërhiqet si fajtor kryesor për dështimet dhe kështu Zaevi bëhet kryetar i LSDM-së më 2013-tën.

Të ngjitesh në majat e politikës gjatë këtyre viteve turbulente nuk qe e lehtë për të. Por tash kur është në maje, mund të fryjnë shumë erëra të forta nga shumë anë, që nuk e bëjnë të lehtë qëndrimin e tij. Në planin e platformës, si çdo politikan dhe subjekt, s'kishte çka të ofrojë të re, përveç gjërave që tashmë mund të ofrohen të përpunuara nga shtabet partiake, me finesa nga njëri te tjetri subjekt. Pra, ofroi PREMTIME, jo aq më kreative se sa konkurrenca tjetër. Por, kush lexon programe dhe shkon pas tyre? Pas disfatës së zgjedhjeve të vitit 2013, të cilat ai i shpalli si të falsifikuara dhe në këtë mënyrë shpëtoi veten nga dorëheqja për

ta zgjatur një periudhë paqartësie, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, kaloi shumë më mirë. Por jo për shkak të platformës zgjedhore, por falë strategjisë e cila dallonte shumë nga ajo e VMRO-së. Së pari, krijoi një terren për zhveshjen e pushtetit të VMRO-së nga imazhi i ndershmërisë, duke ia zbuluar një serë aferash korruptive përmes "bombave" (incizimeve nga përgjimet e paligjshme) dhe e dyta, gjeti "filing" për t'iu afruar votuesve shqiptarë me premtime për më shumë të drejta dhe për zbulim të disa proceseve të dyshimta gjyqësore. Dobësimi i imazhit të VMRO-së, doemos do ta ulte përkrahjen kurse shtimi i votuesve nga tabori shqiptar do t'ia kompensonte votat që i mungonin në taborin maqedonas.

Sigurisht se as vetë Zaevi nuk ka qenë i vetëdijshëm se vërtet një ditë do të bëhet "Gruevski" në çastin kur u tërhoq Branko Cërvenkovski nga politika. Ai në krye të qeverisë, nuk erdhi me aureolën e fituesit, sepse kjo i shpëtoi nga dora për 20-30 mijë vota, të mjaftueshme për "edhe një fitore" të Gruevskit. Por rezultati ishte mbi pritjet, duke ditur humbjet me radhë të partisë së tij dhe "faktori shqiptar" u tregua kyç në inaugurimin e tij. Atje ku dështoi VMRO-ja, nis fitorja e tij: te humbja e përkrahjes ndërkombëtare për shkak të politikave obstruktive. Ai faktor do t'ia vulosë fatin Gruevskit, duke ia marrë faktorin shqiptar (këtu do ta shkelin parimin e fituesit me fituesin në dy taboret etnike). Në këtë mënyrë, Zaevi e rrëmbeu shansin, por u desh të ballafaqohet

**Nëse pushtetin e kani nisur duke mos qenë fitues, vazhdimi i tutjeshëm i karrierës së tij u plotësua me fitoren e madhe në zgjedhjet lokale, duke e çuar Gruevskin në histori. Me këtë fito përkrahjen për frymën e re që prej tij e presin qytetarët, frymë shumë më ndryshe të ushtrimit të pushtetit nga pararendësi**



me PREMTIMET dhe këtu dallon dukshëm nga Gruevski. Nuk do të hezitojë që qysh në fillim të mandatit ta vë në tavolinë negociimi pikërisht çështjen e përdorimit të gjuhës shqipe dhe disa pikave të tjera të Deklaratës së partive shqiptare (në opinion e njohur si "Platforma e Tiranës"). Zgjerimi i përdorimit të gjuhës shqipe, që tash po has në pengesa te kryetari i shtetit, ka një kualitet: atë e kanë votuar të gjitha partitë shqiptare. Hap të madh qeverisja e re bëri edhe me rastin "Monstra", duke i lënë të mbrohen në liri të dyshuarit, me gjasa të mira që të zbulohet e vërteta. Por që nuk është lehtë të realizosh premtimet dhe se nuk mund të shkojë gjithçka si më mirë, tregoi gjykimi për vrasjes së Almirit të mitur, kur pikërisht gjyqësia e "reformuar" i dha një dimension problematik, duke liruuar vrasësin që të gjykohej për aksident trafik!!! Për ta sqaruar këtë rast, në një intervistë të fundit te Nazim Rashidi (TV Alsat), Zaevi u desh të shpjegohet më shumë se dhjetë minuta... Por ky rast flet se sa janë të vështira sprovat pasi ta kesh marrë pushtetin. Sprova më e madhe, ajo që dukej e pakapërcyeshme, kontesti me Greqinë për emrin, Zaevi e tejkaloi, të paktën deri tash, me shumë sukses. Me negociata me takt, diçka prapa perde, diçka publikisht, dhe me kolegun grek, Cipras, përgatitën terrenin e kompromisit. Jehona e kësaj marrëveshjeje, me datën e negociatave me BE-në, në vitin 2019 (prolongim i papritur nga BE-ja për një vit) dhe premtimet edhe nga NATO, e bëjnë Zaevin faktorin

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



më pozitiv sa u përket integriteteve euro-atlantike. Mirëpo, marrëveshja që u nënshkrua para pak javësh, nuk është një formulë Sezami që ia hap vetvetiu portën e Evropës dhe atë të NATO-s, sepse puna më e vështirë vjen më pas, ajo duhet të jetësohet. Obstruksioni që ia bën Gjorge Ivanovi ratifikimit të marrëveshjes edhe mund të tejkalohet në pritje të kalimit të mandatit të tij, por pengesa kryesore mbetet si të binden qytetarët maqedonas se se vendi i tyre nuk ka dalë humbës nga kjo marrëveshje? Edhe nga marrëveshja e fqinjësisë së mirë me Bullgarinë pati shumë debate në këtë vijë, por ajo nuk ka nevojë të shkojë në referendum. Vite me radhë politika dhe qarqe të caktuara akademike ishin përpjekur të ndërtojnë një identitet të ri që fillet i kërkojnë në antikën e largët. Si të binden ata që janë kapur në këtë grip se nuk është cenuar identiteti, kur ata identitetin e kërkojnë në lashtësi? Edhe një herë mund të shpresojë se shqiptarët do ta nxjerrin nga balta, por me kusht që të paktën votuesit e LSDM-së në tërësi të rreshtohen pas tij, gjë që nuk është fort e sigurt, anise vetë Zaevi që tash thotë se ai do të jetë i suksesshëm. Një rrethanë lehtësuese është fakti që paksa janë amortizuar mediati që deri dje ishin me qeverinë e VMRO-së.

Mirëpo, edhe sikur të ishte i suksesshëm ai referendum, do të mbyllë vetëm një kapitull të çështjeve të rënda politike. Të mos harrojmë se platforma PËR JETË NË MAQEDONI, me të cilën erdhi në pushtet, nënkupton shumë më shumë. Nënkupton zhvillim, rritje prodhimtarie, shtim rrogash, hapje vende pune (jo vetëm në administratë) rritje standardi, ulje çmimesh të shërbimeve... Në shikim të parë duket se me disa veprime Zaevi u përmbahet premtiveve: hoqi taksën e radiotelevizionit (por shtoi akcizën për naftën), ktheu tarifën e lirë të rrymës elektrike, ngriti pagat minimale. Së fundi paralajmëroi edhe heqjen e participimit për shërim spitalor. Ky sigurisht është një lajm i mirë për qytetarët, por si do të gjenden nga arka shtetërore mbi 7 milionë euro për të mbuluar mungesën? A kanë dhënë masat ekonomike shenja se arka do të mbushet nga ekonomia e vendit, apo do të kompenzohen me kredi të reja? Të jesh kryeministër Zaev në këtë fushë, duket gjë më e natyrshe, sepse vjen nga biznesi, me çka më së miri duhet t'i kuptojë nevojat por dhe masat. Por, çfarëdo që të ndërmerret, efektet nuk mund të vijnë menjëherë (bile, në këtë vit qeverisje parametrat ekonomikë janë negativë). Të jesh Zaev, do të thotë të realizosh premtimet tua, por dhe të pastrosh "mbeturinat" e të gjithë pararendësve (madje edhe të akuzoesh edhe për bëmat e të tjerëve).

Gjithnjë e më të forta janë akuzat edhe për procesin e emigrimit, sikur ikja e njerëzve për shanse pune jashtë vendit të ketë lindur pikërisht në vitin e parë të kësaj qeverie, që nuk është e vërtetë. Poashtu nuk është lehtë të menaxhosh edhe lëndët për të cilat akuzohen ish-pjesëtarë të qeverisjes së kaluar, premtimi për kthimin e parave si përfitim nga aferat korruptive, etj., si dhe të mbroresh edhe nga akuzat e opozitës për gjëra të ngjashme (gjithnjë e më shpesh Mickovski ia përmend vëllain Vice Zaev si dikur Mijallkovin Gruevskit).

Pra, pushteti të jep shanset për të bërë punë të mëdha, por dhe është një gropë e hapur gjithnjë, ku mund të biesh shumë lehtë. Zaevi është në rrethana ku ecën jo si mbi ndonjë gropë, por mbi humnerë, ku mund të gjendet nga një pakujdesi më e vogël. Ai nuk e ka përkrahjen absolute mediale për gjithçka (është pozitiv ky trend, sepse flet për liri më të madhe të shtypit). Ai nuk e ka komoditetin që ka pasur Gruevski me shumicë absolute (me mbi dy të tretat), edhe pse sadopak e shtoi shumicën e vet parlamentare. Në atë shumicë e ka përfshirë edhe Amdi Bajramin, i cili deri dje i këndonte në dasmë Gruevskit "Zašto su ti družje pobebele kose?" ("Pse jaran të janë thinjur flokët!"). Flokët e thinjura janë një simbolikë më tepër për atë që e pret Zaevin, i cili mbi shpinë ka shumë premtime e nevoja të qytetarëve dhe mundësitë shumë më të vogla, për shkak të cilave mund të "plaket" para kohe... Pra, të jesh Zaev nuk është aq idilike sa duket. Nga këndvështrimi estetik, është me flokë të zeza. Njësoj i kishte të zeza flokët edhe Gruevski para se të bëhej kryeministër dhe sot është në një moshë kur jo domosdo duhet t'i kesh flokët e bardha, por ai tashmë është thinjur nga dhjetë vjetët e jetës dinamike e stresuese të kryeministrit.

Me një fjalë, të jesh Zaev, domosdo duhet të jesh politikan i guximshëm, pragmatik dhe ngapak edhe vizionar dhe ëndërrues përtej asaj që e bëjnë të tjerët, por dhe një udhëtar me shumë bashkudhëtarë të dyshimtë rreth vetes, kur nuk e di kur mund të të lënë në rrugë, siç bënë disa nga tabori i vet (Ferid Muhiq) me mospërkrahjen e marrëveshjes për emrin, ose siç mund të jenë partnerët e koalicionit, që sikush ngre kah vetja. Nëse pushtetin e ka nisur duke mos qenë fitues, vazhdimi i tutjeshëm i karrierës së tij u plotësua me fitoren e madhe në zgjedhjet lokale, duke e çuar Gruevskin në histori. Me këtë fitoi përkrahjen për frymën e re që prej tij e presin qytetarët, frymë shumë më ndryshe të ushtrimit të pushtetit nga pararendësi.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## Ku është puna e gjuhës shqipe?



Nga  
Dr. Arben TARAVARI



Në euforinë e ndryshimit të emrit që si çdo gjest i forcur i kushtoi shumë diplomacisë së brishtë ballkanike, duket se ka mbetur në hije çështja e gjuhës shqipe?

Në negociatat për këtë çështje, në menunë të mbushur me alternativa, shumica shqiptare mbajti pozicion zvicëran pa qenë Zvicër për fat të keq! Qëndrimi neutral i atyre pak shqiptarëve që qeverisin në fakt realisht ishte "inekzistencë" e tyre për kështu gjërash! Ali Ahmeti duket se vuan nga një gjendje obsesive-konvulsive pasi nuk sheh dhe nuk mendon asgjë përveç aderimit të Maqedonisë në NATO. Që në fakt nga mania e Ahmetit për në NATO nuk është gjë tjetër veçse një neurozë obsesive prapa të cilës ky njeri fsheh dhe ndaj vetes dëshitim e madh politik! Aliu edhe pse shqiptarët që jetojnë në Maqedoni rrezikojnë të shkojnë prapa Diellit si komb, as nuk shqetësohet një fije për këtë fakt, ai do NATO-n! Ky proces është shumë i rëndësishëm për të gjithë ne por dallimi është që ne duam të shkojmë të identifikuar si shqiptarë në këtë organizatë, kurse duket se për grupin e vjetruar politik nuk është fare e rëndësishme nëse hyjmë si etni e dalluar apo si një popull i asimiluar. Me termin "etni e dalluar" dua të nënkuptoj që ne, shqiptarëve të na identifikojnë si të tillë, që bota të di zyrtarisht që në këtë shtet përveç të tjerëve, jeton dhe një popull që quhet Shqiptar! Kërkoj ndjesë për termin "Të tjerëve" pasi tingëllon neglizhues, Fan Noli do thoshte "embarasues", e kam dëgjuar t'a përdorin këtë përcaktues për ne shqiptarët, dhe nuk më ka më ka ardhur mirë. Ndaj për të ardhur tek një konkluzë e drejtë, për mua dhe shumicën dërrmuese të shqiptarëve që nuk përfaqësohen nga "pakica qeverisëse shqiptare", pra për ne shqiptarët është e rëndësishme që çdo etni të rrojë e të gëzojë në har-

moni me traditën, gjuhën, zakonet e veta, e më pastaj është vetëm kjo harmoni që siguron një raport të mirë ndër-etnik.

Nato nuk na do të mërzhitur, as nuk na qas e as nuk afron. Ky fakt duhet bërë i qartë dhe për z. Ahmeti i cili duket se ka pësuar një amnezis memoria dhe ka harruar shumë nga e kaluara e tij. Shndërrimi i pabesueshëm i këtij njeriu është rast që ia vlen të studiohet, por për momentin të përqendrohemi tek dyshimi im që dhëntë Zoti e nuk del i vërtetë! Ky statusi i gjuhës shqipe, me ndryshimit e emrit të Maqedonisë si do jetë?!

Do jetë shqipja zyrtare?!

Ndoshta as nuk diskutohet që do jetë, por na ndjeni nëse kemi nevojë t'a dëgjojmë qartë e saktë nga insitucionet kompetente këtë pohim! Dyshimi im është i drejtë, pasi nuk ka shumë kohë që gjuha shqipe u fut në status juridik më të favorshëm. Marrëveshja e Ohrit ose më drejtë Marrëveshja e Zorit nuk u zbatua por u interpretua, e kështu mbeti udhëve duke u zvarritur çështja e gjuhës shqipe.

Tani, duket se gjëkund nuk po na del ndonjëri dhe të na thotë se ku është gjuha shqipe në këtë meselenë e re të emrit! Dhe mendoj se i takon dhëndrit që kemi vënë ose që është vetvënë në krye të Qeverisë të na thotë diçka për këtë punë.

Jo për të ndarë punët me shovinizëm, por për të qenë realist deri në fund, nuk mendoj se i takon Zaevit më shumë se Ahmetit që të na mbajë të informuar për fatin e gjuhës shqipe... Fati i gjuhës shqipe duket si fjali epike, por për fat të keq ne jetojmë ende në vorbullën e një Epoke Parahistorike, ku ende duan të na zhdukim si identitet, si gjuhë, si histori!

Dhe e keqja është që khapsapana kombëtare mban për flamurtar shqiptar! Sigurisht që është shumë me vlerë që Maqedonia të shkojë në NATO, që edhe të jetë pjesë e

Është fat dhe krenari që shqiptarët nuk kanë dalë kurrë në rrugë të protestojnë kundër gjuhës maqedonase, por kjo s'do të thotë që mos vrasim mendjen për gjuhën tonë se ashtu askush nuk na do e nuk na respekton!



Bashkimit Evropian, por puna është që duhet të ekzistojmë pa të shkojmë! Nëse vazhdojmë dhe shohim kolltuqet e ngrohta të pushtetit, duke shitur gjuhë, komb, traditë e çdo gjë që na identifikon atëherë nuk bëhemi as për në hartë gjeografike e jo më hartë institucionale!

Është fat dhe krenari që shqiptarët nuk kanë dalë kurrë në rrugë të protestojnë kundër gjuhës maqedonase, por kjo s'do të thotë që mos vrasim mendjen për gjuhën tonë se ashtu askush nuk na do e nuk na respekton!


Ata që fshehin emrin e nënës dhe babait, mohojnë përkatësinë e tyre janë njerëz me probleme të thella karakteriale, të dëmshëm për veten dhe për ata që i rrethojnë, ndaj ju i lutemi atyre dasmorëve që janë shtruar në qeveri të gjejnë pak kohë e të lënë ahengun, të na thonë se cili është statusi i gjuhës shqipe, ndryshe do kalojë puna prapë në dorë të krushkut, Zaevit, po nuk është normale që krushku të na dojë më shumë se ata që deklarohen se janë gjaku jonë e që dikur madje na thërrisinin t'i votonim në emër të gjakut!

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

## FJALËKRYQI KLASIK

### HORIZONTALISHT

3. Pjesë e trupit, midis
5. E çarë, gropë jo shumë e thellë
7. Grumbull gjërash me vlerë
9. Titull kishtar më i ulët se prifti
10. Luftë në rrugën e Zotit
12. Kollomboç
13. Rrethoj me mur
15. "Njeri i traditës së Muhamedit"
16. Ish futbollisti turk, Shykyr
18. Shajak i bardhë e i hollë
20. Qytet në Dalmaci
23. Thirrje telefonike
24. Ithtar i snobizmit
26. Mbuloja (koke) e luftëtarëve
28. Kapitulli i fundit i Kuranit
29. Ylli më i ndritshëm në Yjësinë e Shqiponjës
30. Paraardhës i rumunëve
31. Prçarje e dy grupeve, ndarje
- 33. Këngëtarja jonë në foto**
41. Qytet në Lituani
- 42. Instrumenti i të atit të këngëtares në foto**
43. Për (lat.)
44. Makinë luftarake e blinduar
47. Këngëtari Ozborn
48. Bashkim qelizash të njëllojta (sh.)
49. Klubi i Madridit.




### VERTIKALISHT


- 1. Emri i të atit të këngëtares në foto, (anëtar i grupit "Elita 5")**
2. I thekshëm
3. Paratë, të hollat
3. Shenjë, simbol që ngjitet në petka
4. Ish trajneri i boksit, Nimani (shq.)
5. Rajon në Kosovë
6. Mirëpo, ama
8. Softuer komprimimi fajllash
9. Aktori amerikan, Keli
11. Kryeqyteti i Katarit
12. Politikani palestinez, Al-Masri
14. Ndajfolje sasie
15. Shtet ishullor në Oqeanin e Qetë
17. Tregtia kundërligjore
18. ... iacta est! (zar, lat.)
19. Kampioni i vrapimit, Husein
21. Binari
22. Fizikani Njutën
23. Dru gjithor i pyjeve malore
24. Mbiemri i Tunës
25. Simboli i tenesinit
27. Kishë
30. Sëmundja e sheqerit
32. Simboli i stronciumit
33. Fabrika e automjeteve e Pribojit
34. Komision vlerësues
35. Artistja japoneze, Joko
36. Bashkëtingëllore e zanore
37. Ushqehem
38. Revolucionari japonez, Hirobumi
39. Me vështirësi, me shumë mundim
40. I moshës së re
44. Aktorja amerikane, Bening
45. Aktorja amerikane, Mek Gilis.

## Kakuro


### e lehtë



### mesatare



### e vështirë







**KOHA** e lirë  
për më të rinjtë



## Fshehësira




## 15 dallime



## FJALËKRYQI (Kupa Botërore)

Plotësojeni fjalëkryqin duke i shënuar mbiemrat e futbollistëve të ilustruar!



## DEKODIMI

Fjala e kërkuar fillon nga katrori i vogël dhe përfundon te rrethi.  
Duhet të zgjidhni njërën nga katër shkronjat në secilën fushë dhe të vazhdoni në fushën tjetër.  
Në fund, lexuar me radhë fitohet zgjidhja e kërkuar (një shtet evropian).

ABCÇ	DDhEË	FGGjH
IJKL	LIMNNJ	OPQR
RrSShT	ThUVX	XhYZZh

Zgjidhja:


## Mini KENKEN

Në kutizat e dhëna shënohen vetëm numrat 1, 2 dhe 3. Ashtu si te sudoku edhe këtu në çdo rresht dhe kolonë nuk guxon të ketë numra të njëjtë. Numrat në skajet e sipërme të katrorëve e tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë tyre, operacionin matematikor që duhet ta përdorni për të arritur deri te rezultati.

4 ×		3 ×
	9 +	


## SUDOKU "më i madh se"

Përdoren numrat prej 1 deri 9. Vlejnë rregullat e sudokut. Shenja ">" paraqet relacionin "është më i madh se".



## KENKEN

Përdoren numrat prej 1 deri 6. Vlejnë rregullat e sudokut. Numrat tregojnë rezultatin, ndërsa shenjat pranë numrit, operacionin matematikor.




## ARUKONE (Çiftimi)

Bashkoni me vija numrat e njëjtë (çiftet). Vijat nuk guxojnë të priten. Duhet të përfshihen të gjitha fushat!



## NONOGRAMI

Nxini fushat sipas numrave të dhëna. Numrat e dhëna e tregojnë numrin e fushave që duhet të nxihen.



## Film shqiptar, i cili fitoi dy çmime në festivalin: "Hollywood International Moving Pictures Film Festival"



### AKTORËT E FILMIT

1 Anagrami  
SI LAM BUJ', MIQ?!

2 Anagrami  
DA BEST AKTOR (T-F)

3 Anagrami  
S'LEU N' MAJ, FIS (+U)

4 Anagrami  
MIK, SI M'LUAN AI! (N-S)

# SKANDI i kombinuar

Mensur Mamuti	MATERIAL PËR NDERTIM AVIONASH	PIKËSYNIM VAZHDMI I REBUSIT	Q	HUMBJA, DEMI (TURQ)	AMERICIUMI
MORRI I VOGËL, ERGJEZA					
SASI					
KOHA E LIRË	NDOHJA DIKU TJETER NË KOHEN E KRËYERJES SE KRIMIT	FSHAT NË GOSTIVAR	PËREMËR PRONOR NEW ZEALAND		LAVDËRIM
JO NORMAL					
QYTET NË CEKL, BOHDANEC				NJË PARAFJALË NIMON MUÇAJ	
ILINIUMI		KRIKETISTI INDIAN, PAN	HEQ NGA SKAMJA		
ANAGRAMI 1, FITUESI I ÇMIMIT "AKTORI MË I MIRE" (EMRI)					GJERMANIA POLITIKANI KOSOVAR, GASHI
NGJYRË (ANG.)			ETRI ZGJIDHJA E REBUSIT	LANTANI ANAGRAMI 4, (MBIEMRI)	
KOHA E LIRË	MINUTAT JODI				
QË NUK ËSHTE MEKATË					
KOHA E LIRË	LLOJ PESHKU I UJERAVE TE EMBLA (LOSA) URATË				QË KA INERCI
BELGIKA		ANAGRAMI 3, (MBIEMRI) ANAGRAMI 2, (MBIEMRI)			
KOHA E LIRË		KOMUNË NË NORVEGI			AZOTI TËRËSIA E DELEVE
GAFORRE SHKULI I VOGËL PENJSH PER TE QENDISUR		STANDARDI EVROPIAN I NGJYRAVE			
L				ERBIUMI SPANJA	
PYLL			KOMUNË NË ZVICER		

## ARITMOGRIFI - fjala e urtë

1	2	3	4			
5	6	7	8	9	10	
11	12	13	14	15		
16	17	18	19	20	21	
22	23	24	25			
26	27	28	29	30	31	32
33	34	35	36	37	38	39
40	41	42	43	44	45	
46	47	48	49	50		

Pesha
Aktore Amerikane
Mistiku turk, Emre
Një e katërta
Bën hajni
Ndërtesë me dy kate
Periudhë historike (shek. VI-XVIII)
Kujtim (fregji.)
Predhë shpërthyes

Përgjigjet i shënoni në rrjetin me numra (majtas), pastaj, sipas rregullit "numri i njëjtë - shkronja e njëjtë", shkronjat e fituara bartni në tabelë (poshtë)! Do të fitoni një fjalë të urtë.



Përgjigjet përbëhen nga këto rrokje: AR, BË, BOM, ÇE, DY, EM, JE, JU, KA, KU, MA, ME, ME, MES, MO, NUS, RE, RE, SA, TA, TËSH, VEST, VJEDH.

40	43	3	14	5	46	29	11	35	6	23	8	1	47	15	21	42	49	4	36	9	37	20	41		
28	12	45	10	31	22	8	32	48	2	30	39	13	50	7	34	16	26	27	33	17	38	18	44	25	19

## Sudoku

i lehtë

3		9	8		1			
9	7				3	5		
	2	7			9			
			1		2		9	
1		3		7		4		
3	5	2						
	6		9	4				
7	3			1	9			
8	4	7			2			

mesatar

3	4				1			
	8			6	4			
7					8			
2			1			3		
3			2			5	9	
4	9	6						
8								
				5	3	4		
	2	8			7			

i vështirë

	8	4	2					
6			8			1		
3	2				8	7		
8	5		9			2	6	
	9	3			8	1		
7	8					4	5	
5		4					8	
	1	6	7					

### ANAGRAM

**LUAN SI ZEUS**  
(N=R)

Tabela

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14

Anagrami

13	1	3	9	9	1	10	6	14	8

### REBUS?

### SKANDI I KOMBINUAR

Shkronjat e pjesës së hijezuar të fjalëkryqit bartni në tabelë, me ndihmën e të cilave do t'i fitoni zgjidhjet e rebusit dhe të anagramit.

Rebusi

10	5	12	4	3	5	14	7	6	3	14	8	11	10	5

MENSUR MAMUTI	FIS AFRIKAN DEVETË	Z	BANORI I NJE KONTINENTI	QYT. NË RUMANI MBIEMRI DHE EMRI I SHKRIMTARIT ARBERESH	M	RUMANIA	AKTORJA AMERIKANE, LUPINO	NUMËR	KOHA E LIRË	NISESHTE	MOTET RAJON NË AMERIKEN JUGORE	V
A									PREFIKS GJËRAT E BLETARISË			
POLICIA 'SPECIALE' E MAqedonisë						TEATRET						
AUTORI SHQIPTAR, PEZA								PETË				
IMPULSI		DJALOSHI				1						
PRINCI SHQIPTAR, DUKAGJINI		ENERGJIA				2	3	4				NË GJINI NJEREZORE
AUSTRIA		ISH FUTBOLLISTI FRENG, TIERI		5	6	3		2	3			
		ISH TRAJNERI GJERMAN, LATEK										
BANOR I TUNGUZISË			5	7	1	8	3	9	9			
KOHA E LIRË	XHEVAHIR		3	10	11	9	5	12				
	PLLAQË MBATHËSE PER KUAJ											
POHIM			NGJYRË BOJË (BISED.)	13	1	6	3		10			
			PRIFËRINJËTË									
NGSTREMI		GRUAJA E ODIESUT			5	14	13	4			URUGUAJI	I BASHKUJ
		LLQJ QËNDRIMI GJATE FALJES										
IBIE DERËS						12						
NË NGA KATËR LLOJET E LETRAVE TË BIXHOZIT							RAPER ANGLEZ, AÇI					
							NJËSI PËR REZIST. ELEKTRIKE					
HEROLI 'BUESHKEVE TË NEMUNA'			ZERO				QYTEZË NË VOJVODINË		E			
							ANGSTREMI					
APARAT QË PUNON VETË										ARMË GJAHU ME NJË TYTË		

SUDOKU "S" KAKURO ARKONE KENKEN NONGRAMI

SKANDI I KOMBINUAR

ANAGRAM

REBUS?

DALIMET

ARTMOGRIFI

FSHËHSIRRA

MINI KENKEN

DEKODIMI

SKANDI I KOMBINUAR

FJALËKRYQI KLASIK

80 vjeçarët do të dyfishohen ndërmjet 2016 dhe 2080. Gjatë periudhës 2016-2080 pjesa e popullsisë në moshë pune pritet të bjerë në mënyrë të vazhdueshme deri në 2050, përpara se të stabilizohet disi, ndërsa personat e moshuar do të përbëjnë një pjesë në rritje të popullsisë së përgjithshme

Sipas një krahasimi të Eurostat për zhvillimet demografike në Europë, Shqipëria është plakur me ritme shumë më të shpejta se vendet e tjera të kontinentit. Sipas Eurostat moshë mesatare popullsisë në Shqipëri u rrit me 8 vite, nga 29 vjeç në vitin 2006 në 37 vjeç në vitin 2016, teksa në Europë ky ndryshim ka qenë më i avashtë. Moshë mesatare në BE-28 u rrit me 2.8 vjet midis 2006 dhe 2016, duke u rritur nga 39.8 vjet në 42.6 vjet.

Moshë mediane e popullsisë së BE-së më 2016 ishte ishte 42.6 vjet. Kjo do të thotë se gjysma e popullsisë së BE-së 28 ishte më e vjetër se 42.6 vjet, ndërsa gjysma ishte më e re. Në të gjithë shtetet anëtare të BE-së, moshë mesatare luhet nga 36.6 vjet në Irlandë dhe 45.8 vjet në Gjermani, duke konfirmuar strukturat relativisht të reja dhe relativisht të vjetra të popullsisë të regjistruara në secilën nga këto dy

# SHQIPËRIA PO PLAKET MË SHPEJT SE EVROPA DHE RAJONI



shtete anëtare. Mes viteve 2006 dhe 2016, moshë mesatare u rrit në të gjitha vendet anëtare të BE, duke u rritur me 4 ose më shumë vite në Portugal, Greqi, Lituan, Rumani dhe Spanjë, por rekordin e ka mbajtur Shqipëria me 8 vite.

Plakja e popullsisë është një prire afatgjatë e cila filloi disa dekada më parë në Evropë, por në Shqipëri ky proces po ecën me ritme shumë më të shpejta. Eurostat analizon se ky trend është i dukshëm në transformimet e strukturës së moshës së popullsisë dhe reflektohet në një rritje të numrit të personave të moshuar, së ba-

shku me një rënie të numrit të personave në moshë pune në popullatën e përgjithshme.

Pjesa e popullsisë 65 vjeç e lart është duke u rritur në çdo Shtet Anëtar të BE-së, dhe në ato candidate. Rritja në pjesën relative të njerëzve të moshuar mund të shpjegohet me jetëgjatësi më të madh dhe me rënien e lindshmërisë.

Në një përpjekje për të parë tendencat e ardhshme për plakjen e popullsisë, janë bërë parashikimet më të fundit të Eurostat-it për popullsinë që mbulojnë periudhën nga viti 2015 deri në vitin 2080.

Një tjetër aspekt i plakjes së popullsisë është plakja progresive e vetë popullatës së vjetër, pasi rëndësia relative e të moshurave po rritet me një ritëm më të shpejtë se çdo segment tjetër i moshës së popullsisë së BE.

80 vjeçarët do të dyfishohen ndërmjet 2016 dhe 2080. Gjatë periudhës 2016-2080 pjesa e popullsisë në moshë pune pritet të bjerë në mënyrë të vazhdueshme deri në 2050, përpara se të stabilizohet disi, ndërsa personat e moshuar do të përbëjnë një pjesë në rritje të popullsisë së përgjithshme.

(monitor)

## Vuçiç: Serbia do të zhduket

Numri i fëmijëve është gjithnjë e më i vogël, paralajmëroi presidenti serb, Aleksandar Vuçiç, gjatë vizitës në spitalin e lindjes në Aleksinac.

Serbia, sipas tij, do të zhduket si një komb nëse qytetarët nuk do të ndërrojnë vetëdijen e tyre për këtë. "Ne e kemi problemin më të madh me numrin e fëmijëve të lindur. Serbia dhe ne si popull nuk do të jemi në gjendje të mbijetojmë nëse nuk ndryshojmë diçka në kokën tonë", tha Vuçiç. Ai theksoi se shteti dhe Qeveria e Serbisë do të vazhdojnë të punojnë në masat stimuluese për rritjen e nivelit të lindjeve. Sipas fjalëve të tij, rënia më e madhe e numrit të fëmijëve të lindur në Serbi është në Novi Pazar. (KP)



## Trump emëron diplomatin Philip Kosnett, ambasador në Kosovë

Presidenti Donald Trump njoftoi synimin për të emëruar diplomatin Philip S. Kosnett nga Virxhinia, si Ambasador të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Kosovës, sipas Shtëpisë së Bardhë. Kosnett aktualisht është i Ngarkuar me Punë i Përkohshëm në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Ankara. Gjatë karrierës së tij në Shërbimin e Jashtëm, ai ka punuar në tetë misionet e Shteteve të Bashkuara në Evropë, Azi dhe Lindjen e Mesme si dhe në pozita të larta drejtuese në Departamentin e Shtetit. Pjesa më e madhe e karrierës së zotit Kosnett ka qenë e fokusuar në bashkëpunimin ndërkombëtar të sigurisë dhe pajtimin politik. Ai ka shërbyer si Zëvendës Shef Misioni në Uzbekistan dhe në Islandë; si dhe në pozita politike, politiko-ushtarake dhe ekonomike-tregtare në Afganistan, Irak, Kosovë, Hollandë dhe Japoni. Në Uashington ai ka punuar në zyrat e Departamentit të Shtetit për Evropën, kundër-terrorizmit, politiko-ushtarake, të Inteligjencës dhe Kërkimeve, etj. Kosnett është diplomuar në Universitetin e Harvardit. Ai është nderuar me 10 çmime të Departamentit të Shtetit, ka marrë Medaljen e Zyrës së Sekretarit të Mbrojtjes për Shërbim Civil të Jashtëzakonshëm dhe Medaljen e Departamentit të Këmbësorisë për Shërbim Civil të Shkëlqyer. Kosnett flet turqisht, rusisht, holandisht dhe japonisht. (VOA)

## Serbia kërkon ndihmë nga Rusia dhe Kina

Serbia kundërshton hapur përfshirjen e SHBA-ve në dialogun me Kosovën. Kryeministrja e Beogradit thotë se në rast se kjo ndodh, atëherë duhet të përfshihet edhe Rusia e Kina. Ajo shton më tej se shpreson që palët të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve. Kërkesa e Republikës së Kosovës që Shtetet e Bashkuara të Amerikës të përfshihen në bisedimet e Brukselit ka nxjerr reagime të shumta nga Beogradi zyrtar. Kryeministrja serbe, Ana Bernabiç, nuk e sheh të arsyeshme

që të ketë shtete të tjera të përfshira në bisedime. Mirëpo, në rast se evropianët miratojnë kërkesën e Kosovës që SHBA-ja të jetë lojtar i ri, atëherë ajo thotë se edhe Serbia do të vërë kushte. "Nëse angazhohen Shtetet e Bashkuara, me kërkesë të Prishtinës, atëherë me siguri në tryezë duhet të jenë dhe dy fuqitë e mëdha botërore që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, Kina dhe Rusia", është shprehur ajo. Në një intervistë të publikuar nga gazeta "Novosti", shefja e qeverisë ka folur për rolin e presidentit Aleksandër



Vuçiç në bisedimet me Hashim Thaçin. Ajo thotë se presidenti i tyre mori një përgjegjësi të madhe mbi veten për të zgjidhur barrën e madhe. "Pritet të ketë një marrëveshje që do të sigurojë të ardhmen e serbëve në Kosovë, stabilitetin e

Serbisë dhe rajonit", është shprehur Bernabiç. Në pyetjen se a mund të imagjinohet një situatë në të cilën njerëzit refuzojnë një marrëveshje ligjore me Prishtinën, ajo ka thënë se personat e caktuar duhet të marrin përgjegjësinë për të ardhmen e tyre dhe për të ardhmen e fëmijëve të tyre. "Do të kemi një kompromis të pranueshëm reciprokisht në tryezë, para së gjithash të pranueshme për Serbinë, besoj se njerëzit do të qëndrojnë prapa presidentit të tyre dhe qeverisë", ka deklaruar ajo.

## Kosova ka vija të kuqe në dialogun me Serbinë

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj në një konferencë për media pas mbledhjes së Qeverisë së Kosovës tha se Kosova i ka përcaktuar parimet e veta në dialogun me Serbinë. Haradinaj duke folur për dialogun Kosovë-Serbi tha se nuk do të ketë ndarje dhe as shkëmbim terriroresh.

"Dalja nga kjo gjendje është dakordim i disa parimeve të dialogut. Ne si Kosovë kemi përcaktuar parimet tona, s'ka

ndarje as shkëmbim terriroresh, as lëvizje të kufijve Kosovë-Serbi, s'ka defunksionalizim të tipit Kosova-Srpska", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, nuk ka alternativë tjetër pos dialogut. "Në dialog është mirë që institucionet të jenë të përfshira si edhe parlamenti, partitë politike pozitive dhe opozitë", tha Haradinaj, duke shtuar se në Kosova ka vija të kuqe në dialogun me Serbinë. Ai po ashtu tha se Qeveria e Kosovës ka

nxjerr raport për të arriturat dhe sfidat të cilat kanë buruar nga zbatimi i marrëveshjeve të dialogut Kosovë-Serbi, në Bruksel. Haradinaj tha se marrëveshjet e arritura janë zbatuar pjesërisht e disa nuk janë zbatuar fare siç është Marrëveshje për Energjinë. Kryeministri Haradinaj foli edhe për kërcënimin dhe shantazhet që po ia bën Serbia pjesëtarëve të FSK-së nga komuniteti serb. Ai theksoi se

ndërhyrja e Serbisë në Kosovë është e papranueshme dhe e pakuptimtë. "Është e pakuptimtë qasja e Serbisë në subjektivitetin ndërkombëtar të Kosovës si dhe ulja në tavolinën e dialogut. Është e papranueshme ndërhyrja e tyre, kërcënimin, shantazhet ndaj pjesëtarëve të FSK-së. Lista është e gjatë dhe e papranueshme e veprimeve të Serbisë në Kosovë", tha ndër të tjera Haradinaj. (Telegrafi)



Një ish-zhytës i marinës në Tajlandë ka vdekur ndërsa ka marrë pjesë në përpjekjet për të shpëtuar 12 djem dhe trajneri i tyre i futbollit i bllokuar në një shpellë të përmbytur në Tajlandë

Ajo që dyshohej po ndodh. 12 djemtë e bllokuar prej 11 ditësh në shpellën "Tham Luang" në Tajlandë, kanë nisur të praktikojnë me pajisjet e zhytjes, në kuadër të njërës prej planeve për daljen në sipërfaqe, megjithëse nuk ka një afat të përcaktuar për këtë.

Grupi i futbollistëve të vegjël nuk di not dhe as që bëhet fjalë të dijë të zhytet, prandaj autoritetet kanë vendosur të marrin masa për atë që duket mënyra e vetme e shpëtimit.

Një nga hipotezat ishte që djemtë e vegjël të prisnin disa muaj, derisa ujërat e përmbytjes të tërhiqeshin, por me reshjet e reja të parashikuara këtë fundjavë duket se kjo ide nuk vlen. Prej ditësh, përmes pompave të fuqishme, autoritetet po përpunojnë të largojnë sa më shumë ujë nga shpella dhe kanë arritur të ulin nivelin e tij me 40 cm.

Por, mjaftojnë pak orë reshje të parashikuara gjatë fundjavës për të zhbërë të gjithë këtë punë kolosale. Prandaj, plani më i artishëm duket ai i nxjerrjes nga shpella përmes zhytjes nën ujë, e për

FAT I FËMIJËVE TË BLOKUAR NË TAJLANDË

# I VETMI MJET SHPËTIMI TË MËSOJNË ZHYTJEN



këtë arsye djemtë duhet të përpunohen të mësojnë sa më shumë në kohën e shkurtër që ka mbetur.

Një plan mjaft i rrezikshëm, pasi në disa vende shpella është kaq e ngushtë, sa që zhytja duhet bërë pa pajisje. Autoritetet u zotuan se do të bëjnë gjithçka për të shpëtuar 12 futbollistët dhe trajnerin e tyre, ndërsa familjet e

djemve presin me ankth që të marrin vesh shpëtimit e tyre nga thellësia e shpellës.

Ndërkohë, një ish-zhytës i marinës në Tajlandë ka vdekur ndërsa ka marrë pjesë në përpjekjet për të shpëtuar 12 djem dhe trajneri i tyre i futbollit i bllokuar në një shpellë të përmbytur në Tajlandë. Saman Gunan humbi vetëdijen në

rrugën e tij jashtë kompleksit të shpellës Tham Luang, ku ai kishte dhënë furnizime. "Puna e tij ishte të jepte oksigjen, por nuk kishte mjaft për të shkuar prapa", tha një zyrtar. Ai u nxor nga shoku i tij i zhytjes, por nuk mundi të ringjallej. Saman Gunan kishte lënë marinën por u kthye për të ndihmuar në operacionin e shpëtimit.




## BE vazhdon edhe zyrtarisht sanksionet kundër Rosisë

Sanksionet e vëna fillimisht më 2014, janë masë ndëshkuese për Rusinë, pas vendimit të kësaj të fundit për të aneksuar Krimenë si dhe për mbështetjen e separatistëve rusë në konfliktin në lindje të Ukrainës. Sanksionet janë miratuar më 5 korrik dhe vijnë pas debatit të liderëve të Bashkimit Evropian për këtë çështje në samitin që është mbajtur në Bruksel më 29 qershor. Sanksionet godasin sistemin bankar dhe atë të energjisë në Rusi. Në samitin e BE-së, kancelarja gjermane, Angela Merkel dhe presidenti francez, Emmanuel Macron kanë informuar homologët e tyre evropianë për nivelin e zbatimit të marrëveshjeve të Minskut, të cilat janë të lidhura me sanksione. Marrëveshjet e Minskut janë arritur më 2014 dhe 2015 në kryeqytetin bjellorus, me qëllim të zgjidhjes së konfliktit dhe kanë bërë thirrje për një varg marrëveshjesh për armëpushim në lindje të Ukrainës, mirëpo asnjëra prej tyre nuk ka qenë e suksesshme. Nga prilli i vitit 2014, në shumë se 10,000 persona kanë vdekur në luftimet në mes të forcave të Kievit dhe separatistëve, që kontrollojnë disa zona në rajonet Donetsk dhe Luhansk në lindje të Ukrainës. Të dyja palët akuzojnë njëra-tjetër për shkelje të vazhdueshme të marrëveshjeve. Liderët e BE-së do të shqyrtojnë mundësinë e vazhimit të sanksioneve pas muajit janar, në takimin e tyre të planifikuar për muajin dhjetor.

## Izraeli mund të sulmojë Sirinë

Ministri izraelit i Sigurisë Gollad Erdan i paralajmëroi Sirinë dhe Rusinë se Izraeli mundet t'i sulmojë forcat qeveritare në Siri. Ai shtoi se sulmi ka mundur të ndodhë nëse Siria dhe Rusia mundohen të vendosin njësi të tyre në zonën kufitare të demilitarizuar në Rafshnaltën e Golanit. "Duhet të kontrollojmë nëse rusët dhe Qeveria e Asadit nuk kanë prani të armatosur në rajonet të cilat janë demilitarizuar", potencoi Erdan. Ai në pyetjen nëse Izraeli është i gatshëm të zbatojë masa parandaluese kundër armatës siriane u

përgjigj me bindje. Armata siriane muajin e kaluar ngriti ofensivë të madhe në krahinën jugore Dera, ndërsa pritet faza e ardhshme e ofensivës të zbatohet në krahinën e cila është nën kontroll të kryengritësve Ketira, e cila është në afërsi të Rafshnaltës kontestuese të Golanit. Presidenti i Rosisë, Vladimir Putin javën e kaluar dy herë bëri thirrje në respektimin e armëpushimit izraelit-sirian nga viti 1974, me të cilën është ndaluar stacionimi i teknikës ushtarake dhe personelit të palës siriane dhe izraelite nga Rafshnaltë e Golanit.



## TAKIMI TRUMP-PUTIN

# Në fokus "Russiagate", lufta hibride dhe Ballkani



Mediat amerikane kanë zbardhur axhendën me të cilën presidenti Donald Trump do të paraqitet në takimin me homologun Putin. Në fokus të bisedimeve do të jenë ndërhyrja ruse në zgjedhje, lufta hibride dhe Ballkani.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka në plan të ngrejë çështjen e ndërhyrjes së përfolur ruse në zgjedhjet e 2016-s në takimin që do të zhvillojë më vonë gjatë muajit me homologun Vladimir Putin. Lajmin e ka bërë të ditur një zyrtar për

"Eall Street Journal", i cili ka saktësuar se shefi i Shtëpisë së Bardhë do të diskutojë edhe për ato që njihen si "aktivitetet dashakeqe" të Rosisë në Europë, si dhe për zërat se Rusia zotëron teknologji të ndaluar ushtarake.

Trump dhe Putin do të takohen më 16 korrik në Helsinki, për atë që do të jetë takimi i parë dypalësh mes tyre. Fillimisht dy kërret e shteteve do të takohen vetëm për vetëm dhe më vonë gjatë ditës me këshilltarët e tyre për një format më të

gjërë. Në fokus do të jetë edhe "lufta hibride", siç njihet ndryshe përdorimi i informacionit për qëllime politike ose ushtarake, si dhe politikat e Kremlinit në Ballkan dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Kjo e fundit më herët gjatë vitit akuzoi Moskën se kishte urdhëruar sulmin me gaz nervin ndaj ish-agentit rus në Angli, Sergei Skripal. Lidhur me këtë çështje, vendet e Bashkimit Evropian mbështetën Britaninë dhe Shtetet e Bashkuara përforcuan sanksionet ndaj Rosisë.

# EDICIONI I 17 I DOKUFEST, SHPALLET PROGRAMI I FILMAVE GARUES

DokuFest ka shpallur të premtën programin e filmave garues për edicionin e 17, që do të mbahet në Prizren nga data 3-11 gusht.

Në festival do të shfaqen 100 filma në gjashtë kategoritë garuese të tij e që përfaqësojnë 40 shtete, përfshirë dhjetë premiera botërore, katër premiera ndërkombëtare dhe një numër të premierave evropiane dhe rajonale. Të gjithë filmat tjerë që shfaqen në festival do të kenë premierën kosovare. Filma dokumentar të jashtëzakonshëm si dhe një numër i mrekullueshëm i filmave të shkurtë dhe të kinemasë eksperimentale është çka e karakterizon përzgjedhjen e këtij edicioni.

Një numër i filmëbërësve do të rikthehen të prezantojnë filmat e tyre për herë të dytë ose tretë në festival ndërsa programi përfshinë edhe filmëbërës të rinj puna e të cilëve prezantohet nëpër seksionet garuese. Në ditët në vijim festivali do të vazhdojë të shpallë programet tjera speciale, përfshirë edhe programin e njohur View



From the World si dhe programin e kuruar për temën qendrore të festivalit 'Reflektimi'.

"Të guximshëm dhe avanturistik, kështu do t'i etiketoja shumë

prej filmave dhe regjisorëve pas tyre", tha Veton Nurkollari, Drejtor Artistik i festivalit. "DokuFest vazhdon të sjellë më të mirën nga fusha e filmit në Prizren dhe Kosovë dhe

ne jemi të kënaqur që edhe njëherë jemi në gjendje të prezantojmë veprat e cilësisë më të lartë nga filmëbërërit e ri dhe mjeshtërat e kinemasë".



## Në strugë starton "Këngë Jeho 2018"

Mbrëmë (epremte) në qytetin e Strugës ka filluar edicioni i 27-të me radhë i Festivalit ndërkombëtar "Këngë Jeho 2018". Në këtë festival marrin pjesë gjithsej 16 shoqëri kulturore artistike nga Maqedonia, Kosova e Shqipëria, tha për Gazetën Koha, drejtori i festivalit Zeni Jusufi. Festivali do të mbahet tre netë me radhë, duke filluar nga sonte, nesër dhe pasnesër respektivisht më 6, 7 dhe 8 korrik. 1 Hapja e festivalit bëhet sonte në 20 e 30 në Sheshin e Qytetit. Sipas Jusufit, festivali nuk ka karakter garues ndërsa është përkrahur nga Ministria e Kulturës dhe Komuna e Strugës.



## "Trekëndëshi poetik i paqes" ka hapur konkurrimin e poetëve për pjesëmarrje

Luten krijuesit nga Zona e Trekëndëshit kufitar Kosovë – Serbi – Maqedoni si dhe nga hapësira mbarëshqiptare e diaspora që të konkurrojnë me nga një poezi të pabotuar për Manifestimin Rajonal të Poezisë "Trekëndëshi Poetik i Paqes", i cili do të mbahet kah fundi i gushtit, e që thjeshtë është një Festival Ballkanik i Poezisë, ka bërë të ditur organizatori "Ars Club "Beqir Musliu". Afati i dërgimit është deri më 26 korrik 2018 përmes faqes

së Ars Clubit në facebook, apo edhe emailit: rrustemi1959@gmail.com. Një Juri letrare e Ars Clubit "Beqir Musliu", do të bëjë përzgjedhjen e poezive më të arrira artistikisht dhe, do t'i ftojë poetët – autorët e poezive të përzgjedhura, në këtë Manifestim. Poezitë e përzgjedhura, përveç që do të lexohen, njëkohësisht edhe botohen në revistën e këtij Manifestimi që mbanë të njëjtin emër, "Trekëndëshi poetik i paqes".

## Filmi "Islamophobia" prezantohet në Shqipëri

Shqipëria do të jetë pjesë e filmit më të ri nga Hollywood mbi temën e Islamofobisë. Harmonia fetare historike në vendin tonë është parë si një aspekt frymëzues për t'i dhënë botës një model.

Regjisori i Hollywood George Edde dhe producentët e filmit "Islamophobia" janë në Tiranë duke prezantuar projektin.

Filmi do të sjellë në Shqipëri yjet e Hollywood, Mel Gibson, Jean-Claude Van Damme dhe Steven Seagal, shkruan Gazeta Shqip.

Në këtë film merr pjesë edhe aktorja shqiptare Teuta Turku, e cila edhe ka bërë të mundur që producentët të përzgjedhin Shqipërinë si model për ti dhënë mesazhin botës për harmoni ndërfaqetare. Skenari i filmit është realizuar nga Omer Sarikaya. Sipas tij, është



xhiruar 80% e filmit dhe vetëm 20% do të realizohet në Shqipëri.

"Filmi ka të bëjë me Islamofobinë ku brenda tij ndërthuren paqja dhe toleranca. Shqipëria pa diskutim është një vend i përshtatshëm për këtë film më këtë tematikë. Ne kemi në këtë

film 29 aktorë nga 29 vende të ndryshme të botës", është shprehur ai.

Ndërsa sipas producentit George Edde filmi nuk do të ishte i plotë pa Shqipërinë. Por cila është historia mbi të cilën do të ndërtohet ky prodhim kinematografik? Kur filloj

lufta e Bosnjës më 1984 Omar ishte vetëm 8 vjeç. Babai i tij i krisherë u zhduk dhe pas kësaj ngjarjeje Omar dhe nëna e tij emigruan në Rotterdam për të nisur një jetë të re, shkruan Gazeta Shqip.

Tashmë një student i ri në Universiteti Omar lufton me krizën e identitetit, shpesh përballë diskriminimit dhe racizmit. Përfundimisht ai konvertohet në mysliman.

Kërkimi i tij për më shumë informacion rreth fesë do ta vendosi emrin e tij në listën e të kërkuarve nga CIA për shkak të disa miqve të tij. Që nga ai moment jeta e tij merr një kthesë dramatike. Kjo është historia që do të ketë një pjesë të xhirimeve dhe në Shqipëri, duke i bërë imazhet e vendit tonë pjesë të ekranit të madh të Hollywood.

## Vdes regjisori i "Holokaustit"



Kineasti dhe shkrimtari francez, Claude Lanzmann, regjisor i dokumentarit të famshëm "Holokausti", vdiq sot në moshën 92-vjeçare, bëri të ditur shtëpia e tij botuese, raporton AFP. "Claude Lanzmann vdiq sot në mëngjes në shtëpinë e tij. Ai ishte në gjendje të rënduar që prej disa ditësh", theksoi një zëdhënës i "Callimard". Regjisori i "Holokaustit", dokumentar i konsideruar i jashtëzakonshëm kushtuar shfarosjes së hebrenjve të Europës, Claude Lanzmann ka qenë gjithashtu gazetar, drejtor i revistës "Temps Modernes" dhe shkrimtar. Mik i filozofit Jean-Paul Sartre, shok i Simone de Beauvoir, ai ishte një mbështetës i kauzës së Izraelit.

HAMZA JASHARI FLET PAS SUKSESIT HISTORIK PËR XHUDON E MAQEDONISË

# I LUMTUR QË IA SOLLA MAQEDONISË MEDALJEN E PARË NGA KE

Po ndjehem mirë dhe jam i lumtur që ia solla Maqedonisë medaljen e parë nga një eveniment siç është Kampionati Evropian i cili u mbajt në Sarajevë. Isha me besim të lartë dhe pa asnjë tremë para fillimit të këtij eventi", thotë për "ipon.mk", transmeton gazeta KOHA



Shkup, 6 korrik - Hamza Jashari javën e kaluar në Kampionatin Evropian në xhudo për kadetë, fitoi medaljen e bronzit, duke hyrë në historinë e xhudos së Maqedonisë si fitues i parë i cili ka fituar medalje në një garë të madhe zyrtare. Xhudisti shkupjan tregoi luftëra të shkëlqyera duke arritur të fitojë pesë ipona, derisa fatkeqësisht nuk arriti të luftojë për medaljen e arit. Megjithatë, Hamza dëshmoi se rezultatet e tij në Kupat Evropiane, nuk janë rastësisht të arritura, ndërsa Federata Ndërkombëtare e Xhudos para fillimit të kampionatit e renditi në mesin e favoritëve për medalje, sepse Hamza Jashari në Ku-

pat Evropiane fitoi tre medalje, dy të arit dhe një të argjendtë. Medaljet e arit i fitoi në Zagreb 2018 dhe Gior (Hungari) 2017, të argjendtën në Folenika 2018 në Itali, derisa në Kupën Afrikane në Tunizi 2018, e fitoi medaljen e

argjendtë. "Po ndjehem mirë dhe jam i lumtur që ia solla Maqedonisë medaljen e parë nga një eveniment siç është Kampionati Evropian i cili u mbajt në Sarajevë. Isha me besim të lartë dhe pa asnjë tremë para fillimit të këtij

evenimenti", thotë për "ipon.mk", transmeton gazeta KOHA, Jashari. Ai shpejtë ka mundur gjermanin Denis Mauer, ndërsa flet për luftën vendimtare për medaljen historike. "Në luftën vendimtare për medalje vendimtare ishte dëshira për fitore, e cila rezultoi me ipon për vetëm nëntë sekonda luftë", shtoi më tej Hamza. Ndryshe, lufta vendimtare për të hyrë në gjysmëfinale dhe mundësia për të luftuar për medaljen e arit, Hamza e humbi nga Javier Pena Insausti. "Fakti që nuk e fitova këtë luftë ishte gabimi teknik që ishte vendimtar ndaj xhudistit spanjoll. Deri më ditën e sotme mendoj se rezultati nga kjo përballje mundet të jetë në favorin tim. Por, ky është sporti dhe vazhdoj tutje". Në fund, Hamza Jashari tregoi se sfida e ardhshme e tij do të jenë Lojërat Olimpikë në Buenos Aires të Argjentinës. "Në rast se do të kem rast për pjesëmarrje dhe ofrohen kushte të mira për përgatitje, medalja në këto Lojëra është e arritshme", përfundoi Hamza Jashari. (B.K.)

KUQEZINJTË U  
RIKTHEHEN STËRVITJEVE

## Bejtullai i gatshëm për TNS

Shkup, 6 korrik - Pas tre ditëve të lira që stafi teknik u dha futbollistëve pas kthimit nga Sllovenia ku u zhvillua faza kryesore e përgatitjeve verore, skuadra e Shkëndijës të enjten i është rikthyer punës në Tetovë. Ekipi ka punuar në Reçicë ku stafi teknik ul ngarkesën me pretendim që ekipi të kthejë freskinë e nevojshme pas përgatitjeve intensive. Gëzon gjendja fizike e futbollistëve pasi nuk ka asnjë ankesë lëndimi dhe me ngarkesë maksimale ka punuar edhe Egzon Bejtullai që shkaku i dëmtimit lëshoi para kohe lojën në testin e fundit në Slloveni ndaj Vorskla të Ukrainës (3-1). Nga klubi njoftuan se ekipi do të vazhdojë me këtë temp në Tetovë deri të dielën, ndërsa të hënën shpërngulet në Shkup ku do të presë takimin e parë të eliminatorëve të "Champions League", përballë "The New Saints" të Uellsit, e cila luhet të martën.



## Spektakël i Prishtinës, kualifikohet me goleadë



Prishtina përmbush pritshmëritë duke dhuruar spektakël. Skuadra kosovare kaloi raundin përliminator duke avancuar në raundin e parë kualifikues të "Europa League", pasi triumfoi me rezultatin e thellë 5-0 në sfidën e kthimit ndaj skuadrës nga Gjibraltari Europa Fc. Një sukses i merituar i kryeqytetasve që e dominuan takimin nga fillimi në fund duke mos e vendosur asnjëherë në diskutim kualifikimin. Në ndeshjen e parë në transfertë Prishtina kishte barazuar 1-1 por në sfidën e kthimit në stadiumin "Adem Jashari" të Mitrovicës, bardhekalëtrit nuk i lanë asgjë rastësisë. Kapiteni Armend Dallku zhbllkoi shifrat me

11-metërsh në minutën 9-të ndërkohë që mesfushori nga Republika Demokratike e Kongos, Mankenda dyfishoi shifrat në të 13-ën. Prishtina e vulosi kualifikimin që në pjesën e parë duke e mbyllur atë në avantazhin e tre golave pasi Dallku kthehu në gol një tjetër 11-metërsh në minutën e 35-të. Në pjesën e dytë gjetën rrugën e rrjetës edhe sulmuesi Ahmed Januzi dhe Pefqeli i ardhur në fushë nga stoli. Prishtina avancoi më tej me rezultat të përgjithshëm 6-1 dhe në raundin tjetër do të ketë përballë skuadrën nga Luksemburgu Fola Esch një tjetër kundërshtar i kalueshëm për skuadrën e Mirrel Josës.

SHTOHEN ALTERNATIVAT PËR MAVRAJN

## Opsion Arabia Saudite dhe Italia

Mërgim Mavraj i ka ditët e numëruara te Hamburg. Kjo, në rast se ai kërkon që të vijojë karrierën si profesionist dhe jo si pjesë e skuadrës së 21-vjeçarëve. Prestigjiozja gjermane "Bild" ka bërë me dije se e ardhmja e mbrojtësit të Kombëtares, është e sigurt që do të jetë larg Hamburgut. Sipas saj, shqiptari nuk ka vend në ekip dhe si alternativë e vetme e vijimësisë së kontratës deri në 2019-ën, i është dhënë aktivizimi (jo i sigurt) te skuadra e 21-vjeçarëve. Në këto kushte, vetë mbrojtësi kuqezi është vënë në lëvizje për gjetjen e destinacionit të ri. Nëse në Turqi e bëjnë thujtë të sigurt transferimin te Trabzonspor, për "Bild" nuk është kështu. Pista e Turqisë është shumë e fortë, por ajo shton si



alternativë edhe Serinë B italiane si dhe një mundësi transferimi në Arabinë Saudite. Mediat gjermane bëjnë me dije se shqiptari duhet të saktësojë të ardhmen e tij brenda dy ditësh, kohë e vënë në dispozicion nga Hamburg, pasi në të kundërt mbrojtësi kuqezi duhet të rikthehet në Gjermani.

PËR SHKAK TË LËNDIMIT

## Latifi tërhiqet nga ndeshja ndaj Teixeiras

Luftëtari me prejardhje nga Kosova, Ilir Latifi, nuk do të ndeshet me Glover Teixeiran në UFC. Ilir Latifi ishte paraparë të ndeshet me Teixeiran më datë 22 korrik në kuadër të UFC Hamburg. Por, fatkeqësisht kjo ndeshjeve mes dy luftëtarëve nuk do të mund të ndodh me këtë datë. Për shkak të dëmtimit, Ilir Latifi është i detyruar të tërhiqet nga ndeshja kundër Teixeira në UFC Hamburg më 22 Korrik. Tani, momentalisht UFC është duke punuar për të gjetur zëvendësuesin e tij për t'i bërë një kundërshtar Teixeiras. Është vet Latifi, i cili ka konfirmuar një gjë të tillë, teksa ka kërkuar falje për mos-zhvillimin e këtij meçi. "Do të kthehem përsëri së shpejti, kërkoj falje për



tifozët e mi, UFC dhe Glover Teixeira", ka shkruar Latifi në "Facebook".

**NPK "Tetova" Tetovë**  
Publikon  
**SHPALLJE**

Për dhënien e lokalit afarist dhe kioskave me qira në tregun e qytetit dhe tregun në lagjen "Boris Kidriç" II përmes ofertave në licitacion (ankandi)

Tabela nr. 1

Nr. i hapësirës	Sipërfaqja në m2	Shuma fillestare e qirasë për m2 në EURO
1	22,60	6
2	22,60	6
7	37,00	6
9	45,76	6
10	22,70	4,5
18	68,50	6
36	52,00	5
37	52,00	5
38	5,00	15
39		4500,00 den.
41	30,00	7
42	12,00	11
62/63/64	72,00	6

Tabela nr. 2

Nr. kioskat	Sipërfaqja në m2	Shuma fillestare e qirasë për m2 në EURO
1/2/3/4	61,20	6,5
9-14	36,00	10
15	8,86	12
17/18	24,00	10
19	20,00	10
20	48,00	3

Tregu në lagjen "Boris Kidriç" II

- Lokali afarist u jepet me qira personave shtetas të RM-së, përkatësisht personave juridik të regjistruar me vendbanim në RM-së.
  - Në licitacion mund të marrin pjesë edhe personat juridik shfrytëzues të deritashëm të lokaleve afariste nëse i kanë paguar të gjithë obligimet ndaj ndërmarrjes me shënim të numrit rendor të lokalit afarist nga shpallja.
  - Oferta të dorëzohet bashkë me fotokopje nga regjistrimi gjyqësor.
  - Ofertat të dorëzohen me zarf të vulosur në pjesën e përparme të letrës në këndin e majtë të lartë duhet të shënohet "mos e hap" si dhe numri rendor i lokalit afarist për të cilin konkurrohet. Në mesin e zarfit të shënohet adresa e qiradhënësit, NPK "Tetova"-Tetovë rr."120" p.n.
  - Ofertat të dërgohen në postë me porosi ose me dorëzim në arkivin e ndërmarrjes.
  - Procedura e licitacionit do të zbatohet edhe nëse në atë merr pjesë vetëm një person si qiramarrës që ka ofruar më pak 10 % qira më të lartë nga fillestarja.
  - Kandidati në ofertën duhet ta shënohet lartësinë e qirasë mujore për 1 m2 shprehur në EURO si dhe kohëzgjatjen e qirasë.
  - Si ofertë më e përshtatshme do të vlerësohet ajo për të cilën jepet qira mujore më të lartë për 1 m2.
  - Në shumën e njëjta të qirasë, si më e përshtatshme do të vlerësohet oferta në të cilën pagesa e të njëjtit jepet në shumë të njëhershme për periudhë kohore më të shkurtë.
  - Ofertat jepen në EURO, kurse pagesa e qirasë kryhet në denarë llogaritur sipas kursit të mesëm të BBPM. për 1 EURO në ditën e pagesës.
  - Në shumën e qirasë nuk hyn shumën e mjeteve për shërbimet komunale rrjedhëse (rryma elektrike, uji, nxehtësi).
  - Ofertat të dorëzohen në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit të kësaj shpallje.
  - Me ofertuesin e cila ofertë është e pranuar si më e përshtatshme qiradhënësi lidh kontratë për qira në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të ofertës.
  - Lokali afarist jepet në gjendje emine dhe mund të shihet {do ditë pune.
  - Lokale e paraqitura në tabelën nr. 1 jepen me qira në afat prej 1 viti, ndërsa lokalet e tabelës nr. 2 në afat prej 6 muaj.
- Informata më të hollësishme për lokalit afarist mund të merren në NPK "Tetova" - Tetovë, dhoma nr. 2 ose në tel. 331-167, 335-453 .

NPK "Tetova"-Tetovë



## REPUBLIKA E MAQEDONISË



## KOMUNA E KUMANOVËS

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, alineja 2 dhe paragrafi 8 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 27/14), nenit 22, paragrafi 1, pika 1, paragrafi 2, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 dhe nenit 23, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 nga Ligji për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr.167/15), Kryetari i Komunës së Kumanovës shpall

## KONKURS PUBLIK

për themelimin të marrëdhënies së punës me kohë të caktuar për Zjarrfikës – shpëtues

Për vend pune të kategorisë B, niveli B04, thirrja Zjarrfikës – shpëtues, me shifër të vendit të punës POZH 02 10 B04 000, emërtimi i vendit të punës - Zjarrfikës – shpëtues – 2 (DY) realizues

Kushtet e përgjithshme për plotësimin të vendit të punës për persona të autorizuar zyrtar nga sfera e sigurisë – zjarrfikës, që duhet t'i plotësojnë kandidatët janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Të jetë i moshëritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor, të mos i jet shqiptuar dënimi për ndalesë të kryerjes së profesionit

Përkaj kushteve të përgjithshme, duhet të plotësohet edhe këto kushte të posaçme:

- Kushtet e posaçme të parapara me ligj të posaçëm ose kontratën kolektive për persona të autorizuar zyrtar nga sfera e sigurisë – zjarrfikës, në sferën zjarrfikës profesional – shpëtues të kategorisë V – niveli V4 – zjarrfikës shpëtues janë:

- për të gjithë nivelet e kategorisë B, niveli i kualifikimeve - kualifikimet IV sipas Kornizës së Maqedonisë për kualifikimet me 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO, ose më së paku arsim të mesëm ose të lartë,
- përvojë pune, edhe atë:
- për nivelin B4 me ose pa përvojë pune në profesion, të evidentuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë, si përvojë pune.

(2) Kompetencat e përgjithshme të nevojshme të punës për kategorinë V në nivel themelor janë:

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim
- arritje të rezultateve,
- punë me të tjerë/punë ekipore
- orientim ndaj palëve

Marrëdhënia e punës do të themelohet për kohë të caktuar, me kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Afati i paraqitjes së kandidatëve është 5 (pesë) ditë, duke u llogaritur nga e nesërmja e ditës së shpalljes së Konkursit publik (duke mos e llogaritur vetë ditën e shpalljes).

Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në përputhje me nenin 23, paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta zyrtare e RM" nr. 167/15).

Orari i punës është duke filluar prej orës 07:00 deri në ora 19:00 dhe prej orës 19:00 deri në ora 07:00 dhe ka gjithsej 40 orë në javë dhe është i organizuar me turne.

Vlera monetare e rrogës themelore neto për Zjarrfikës - shpëtues është: 15.612,00 denarë

## Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme të dërgohet në këtë adresë:

Komuna e Kumanovës  
Njësia për menaxhim me resurset njerëzore  
Rr. 11 Tetori p. n., Kumanovë,  
Personi për kontakt: Lubinka Trifunovska  
Kontakt tel.: 031475800

**Komuna e Kumanovës**  
**Kryetar**  
**Maksim Dimitrievski**

Në bazë të nenit 114 paragrafi 4 alineja 7 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/18), dhe Vendimit nga Dekani me nr. 04-621/1 të datës 03.07.20, Dekani i Fakultetit për siguri – Shkup, njësia në kuadër të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir publikon

## KONKURS

Për zgjedhje të:  
**Mësimdhënësit**

- një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat shkencore: Tjera 51610.

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, aktet e Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir dhe aktet e përgjithshme të Fakultetit.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shuma e pagës bazë (në shumë bruto: 56.429,00 denarë) për mësimdhënësin janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimdhënësi.

Fletëparaqitjet të dorëzohen në Arkivin e Fakultetit për siguri, rr. "1" Kolonia Idrizovë nr. 2A, Shkup, me shenjë "Për konkurs".

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: biografi të shkurtë (në tri kopje), dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe posaçme, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe nga një kopje të punimeve të publikuara veças ose në publikim, formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor, mësimor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues. Dokumentet parashtrihen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Konkursi zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

FAKULTETI PËR SIGURI – SHKUP

Në bazë të nenit 126 paragrafi 7 nga ligji për arsim fillor (Gaz. zyrtare e RM nr.103/08, 33/10.....dhe 64/18) dhe neni 71 nga Statuti i shkollës, Këshilli i shkollës SHFK "Kiril dhe Metodi" Stojakovë shpall :

**Shpallje publike**  
për zgjedhje të drejtorit

Për drejtor të shkollës fillore zgjidhet person i cili përpos kushteve të përgjithshme të vërtetuara me Ligjin për marrëdhënie pune, i plotëson edhe kushtet për mësimdhënësi apo bashkëpunëtorë profesional në shkollën fillore dhe ka më së paku 5 vite përvojë pune në punë edukativo-arsimor dhe provim të dhënë për drejtor.

Kandidatët për drejtor duhet ti dorëzojnë dokumentet në vijim:

- Fletëparaqitje me biografi profesionale;
- Diplomë për arsim sipëror të mbaruar;
- Dëshmi që kundër kandidatit nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në momentin e emërimit;
- Vërtetim për 5 vite përvojë pune në institucion për punë edukativo-arsimore ;
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Dëshmi se kundër kandidatit nuk ka aktakuzë që është futur në fuqi ligjore të dhënë nga Gjykata themelore (jo më të vjetër se 6 muaj);
- Dokument për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet;
- Program për punë për periudhë katër vjeçare.

Shpallja zgjatë 8 ditë, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afatet e vërtetuara në nenin 132 nga Ligji për arsim fillor.

Aplikacionet dorëzohen në arkiv apo me postë në adresën:

SHFK "Kiril dhe Metodi" Stojakovë, rr."Marshall Tito" nr.60, Stojakovë

Këshilli shkollor  
SHFK "Kiril dhe Metodi" Stojakovë

## KONKURS

## Gazeta KOHA shpallë konkurs për:

- dy redaktorë (me përvojë pune)
- katër gazetarë (me përvojë pune)

**Kushtet:** Kandidatët të kenë të mbaruar arsimin sipëror, si dhe përvojë në redaktim dhe në raportim nga terreni. Përparësi do të kenë kandidatët, të cilët, përpos gjuhës shqipe, zotërojnë edhe ndonjë gjuhë tjetër.

Të interesuarit duhet që CV-të e tyre t'i dërgojnë në e-mail adresën: [marketing@koha.com.mk](mailto:marketing@koha.com.mk).

Afati i dorëzimit të dokumenteve zgjat deri të mërkurën.

## KORIGJIMI I KONKURSIT

Bëhet korigjimi i konkursit të botuar më datën 06.07.2018 në gazetën "Koha" edhe atë në vend se të qëndroj:

Për zgjedhje të lektorëve të gjuhës maqedonase për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019 në universitetet në Rjekë – Republika e Kroacisë dhe Sosnovjec – Republika e Polonisë, dhe atë në lektoratet në:

Duhet të qëndroj:

Për zgjedhje të lektorëve të gjuhës maqedonase për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019 dhe 2019/2020 në universitetet në Rjekë – Republika e Kroacisë dhe Sosnovjec – Republika e Polonisë, dhe atë në lektoratet në:

## URGJENTISHT

**Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo+Pr+1+Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960**

# PAS 28 TELEFONATAVE TË ANJELIT, RONALDO I THA "PO" JUVENTUSIT

Nëse marrëdhëniet mes Florentino dhe Ronaldos janë në pikën më të ulët të tyre pas nëntë sezonesh Anjeli dhe Kristiano e kanë filluar më të mirë mënyrë. Kishte telefonata të shumta nga presidenti i Juventusit. Në Itali thonë deri në 28 herë. Kristiano ishte i impresionuar me trajtimin dhe nderimin e presidentit, me dëshirën e treguar për ta afruar në Torino. Ai ishte i mahnitur nga respekti i Andrea për figurën e tij, sikur Juventusit të ishte një klub i përulur



Forbes thotë se Kristiano Ronaldo është sportisti i tretë më i paguar në botë falë të ardhurave të tij sportive (61 milionë) dhe reklamave (47). Sponsorizimet e sulmuesit portugez janë tejkuluar vetëm nga boksieri Mejveder. Industria e Ronaldos, mbështetet shumë pak se Madridi kontribuon 21, 25 ose 30 milion neto në vit. Ronaldo nuk largohet, nëse transferimi i tij në Juventus nuk i sjell një dorë të mirë të ardhurash në euro. Ai ka vendosur të largohet nga "Los Blancos" për çështje mosrespektimi, për atë që ai e kupton si një mospërfillje të qartë për figurën e tij, për faktin se klubi nuk mbajti premtimin që iu dha nga Florentino Perez, cili ka bërë numra për Neymarin. Durimi u thye edhe më shumë kur u ul klauzola e tij nga 1 miliardë euro në 100 milionë, të cilën Ronaldo e interpretoi si fyerje. Në këtë skenar u shfaq Juventusit,

klub me të cilin Kristiano u impresionua nga pritja e tifozëve në Itali për ndeshjet e "Champions League", nga madhësia e klubit italian për tu përballuar denjësisht me klubet e tjera në Evropë, e bindi Ronaldon që t'i thotë "PO" Andrea Anjelit. S'ka firmë. Por, ai i ka dhënë fjalën e tij presidentit të "Zonjës së Vjetër". Ronaldo nuk ka nevojë për ndonjë nënshkrim për të vijuar marrëveshjen me Juventusin, të cilët i hapën dyert sapo morën vesh se çmimi i tij kishte rënë në 100 milionë. Kur e mendon, është një lëvizje galopante, të afrosh golashënuesin më të mirë të Real Madrid dhe golashënuesin më të mirë në historinë e "Champions League" për 100 milionë. Po ta krahasosh me vlerën e tregut tani është diçka shumë e vlefshme për Juventusin, për shembull: Barcelona bleu për 105 milionë euro, plus bonuse Dembele, apo Liverpooli që ka bërë

ofertë 180 milionë euro për Asensio. Në anën tjetër, Juventusit dëshiron të transferojë Higuain te Çelisi për 60 milionë euro, një figurë që do të qëndrojë pezull derisa të vendoset e ardhmja e Ronaldos.

## KONTRASTI

Nëse marrëdhëniet mes Florentino dhe Ronaldos janë në pikën më të ulët të tyre pas nëntë sezonesh Anjeli dhe Kristiano e kanë filluar më të mirë mënyrë. Kishte telefonata të shumta nga presidenti i Juventusit. Në Itali thonë deri në 28 herë. Kristiano ishte i impresionuar me trajtimin dhe nderimin e presidentit, me dëshirën e treguar për ta afruar në Torino. Ai ishte i mahnitur nga respekti i Andrea për figurën e tij, sikur Juventusit të ishte një klub i përulur. Përmbledhja ishte si më poshtë: Kristiano, dhe vetëm Kristiano, ishte njeriu i thirrur për të bërë një histori më të

madhe si Juventusit, i cili ishte në prag të fitimit të Kampionëve në vitet e fundit. Ronaldo ishte lojtari përgjegjës për skualifikimin e Juventusit, kampionit në Itali, për t'u ngjitur në majën përfundimtare të Evropës. E gjithë kjo që e bëri atë të largohej nga Madridi, e gjeti atë papritmas në Torino. Dhe kjo nuk është saktësisht për më shumë para, sepse Madridi tani ka barazuar ofertën e Juventusit me 30 milionë neto në vit.

## FJALA ËSHTË LIGJ

Sfida italiane e tërhoqi atë nga fillimi dhe ai u angazhua për zërat që qarkullonin. Fjala e tij është ligj. Sepse pasi u zbulua se ai mund të largohet nga Madridi për 100 milionë, klubet e tjera evropiane kanë qenë në kontakt me Jorge Mendes për të përcjellë disponueshmërinë e tij për të adresuar nënshkrimin. Por kristiano kishte dhënë fjalën e

tij për Juventusin. Ai nuk donte të dëgjonte askënd tjetër, megjithëse ai gjithmonë kishte shpresën për një kthesë të drejtuesve të Reait, të cilët të bënin një gjest të madh për portugezin, gjë që nuk ndodhi dhe pas bisedës telefonike midis përfaqësuesit të tij dhe Jose Angel Sanchez, drejtorit të përgjithshëm të klubit.

## NË MUNGESË TË KONKRETIZIMIT

Kristiano ka shkuar në pushime duke menduar se do të kthehet në Madrid për të përfunduar këtë veprim përpara se të përfundojë në Torino. Etapa e tij në Madrid është gati të mbyllet, tani nga vullneti i të dy palëve, edhe pse është ende për t'u përcaktuar se sa do të arkëtojë Madridi nga kjo marrëveshje. Shitja e shekullit për shifrën prej 100 milionë. Ronaldo ka thënë "PO" tashmë për Juven.

Publicitet

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1, pika 9, të Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e RM nr. 05/02), dhe në lidhje me nenin 19-a dhe 23 nga Ligji për ndërmarrjet publike (Gazeta zyrtare e RM nr. 38/96;6/02;40/03;49/06;22/07;83/09;97/10;6/12;119/13;41/14;138/14;25/15;61/15;39/16 dhe 64/2018), si dhe Vendimi nr. 04-40/4 të datës 04.07.2018 për shpalljen e konkursit publik për zgjedhje të drejtorit të NPK "KLEPA" Gradsko, Kryetari i Komunës Gradsko shpall:

### KONKURS PUBLIK për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale "KLEPA" Gradsko

Shpallet konkurs publik për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale "KLEPA" Gradsko.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkursin publik për zgjedhjen e drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale "KLEPA" Gradsko duhet ti plotësojnë kushtet në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkollën VII/1 të arsimit
- në momentin e zgjedhjes me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- të ketë minimum 5 vjet përvojë pune,
- Së bashku me fletëparaqitjen për konkurs për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes publike komunale kandidatët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin në vijim:

- biografi të shkurtër të kandidatit,
- certifikatë shtetësie të Republikës së Maqedonisë,
- dëshmi për arsim të lartë të mbaruar (diplomë apo certifikatë)
- dëshmi për përvojën e punës që posedon kandidati i cili paraqitet në konkurs për zgjedhje të drejtorit të Ndërmarrjes komunale,
- certifikatë që me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ose sanksioni kundërvajtës për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (original apo kopje të verifikuar në noter, jo më të vjetër së gjashtë muaj)

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në konkursin publik kandidatët ti dorëzojnë me postë në adresën: komuna Gradsko, rr. "Aleksandar Makedonski" nr.70A 1420 Gradsko apo personalisht në arkivin e komunës në të njëjtën adresë, në zarf të mbyllur me shenjë për konkurs publik për zgjedhje të drejtorit të NPK "Klepa" Gradsko.

Kohëzgjatja e afatit për paraqitje në konkursin publik është 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore.

Dokumentet e arritura i kontrollon komisioni tre anëtarësh të zgjedhur nga Kryetari i komunës Gradsko, e cila në afat prej 8 ditë pas përfundimit të afatit të konkursit dokumentacionin e plotë e dërgon deri te kryetari.

Kryetari i komunës gradsko në afat prej 15 ditë nga dita e dorëzimit të dokumentacionit, sjell vendim për zgjedhje të drejtorit.

Dokumentacioni jo i plotë dhe dokumentacioni i dorëzuar pas përfundimit të afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.

Komuna Gradsko  
Kryetar  
Robert Beshovski

## Reali merr talentin e Spanjës për 40 milionë euro

Real Madrid ka arritur marrëveshjen zyrtare me mbrojtësin e kombëtares spanjolle, Alvaro Odriozola, i cili ishte pjesë e "Furisë së Kuqe" në Botërorin rus. Ky operacion i ka kushtuar 40 milionë euro "Los Blancos", të cilat kanë shkuar në arkën e Real Sociedad, ekip me të cilin anësori është aktivizuar. "Real Madridi dhe Real Sociedad kanë rënë dakord për transferimin e lojtarit Alvaro Odriozola, në pritje të ekzaminimit mjekësor lojtari mbetet i lidhur me klubin për gjashtë sezonet e ardhshme", ka shkruar klubi madrilen në komunikatën zyrtare për shtyp. Odriozola, 22 vjeç, do të luajë në të njëjtin krah me Dani Carvahal, por talenti i ri është shumë i preferuar nga trajneri Lopetegui, që mendohet se ka qenë ai çelësi i transferimit të tij. Mbrojtësi bashkohet listës së gjatë të talenteve të Real Madridit që është kthyer në një "kamp"



rigjenerimi brezash me lojtarë si Asensio, Kabelleo, Theo, Vallejo, Vinicius, Rodrygo dhe Lunin

MARADONA TËRHEQAKUZAT

# I KËRKON NDJESË FIFA-S

“E pranoj se disa nga gjërat që thashë janë të papranueshme. Unë respektoj maksimalisht punën e vështirë të FIFA-s dhe gjyqtarëve”, pohoi Maradona

Legjenda e Argjentinës, Diego Maradona, i ka kërkuar ndjesë FIFA-s, për deklaratën e tij se fitorja e Anglisë ndaj Kolumbisë në 1/8-t e finaleve të “Rusi 2018”, ishte një vjedhje historike. Maradona akuzoi gjyqtarin amerikan Mark Geiger se favorizoi Anglinë, teksa qeveria drejtuese e futbollit botëror u shpreh se të tilla fjalë ishin të papranueshme dhe pa baza vërtetësie. Gjithsesi, pas 48 orësh, Maradona tërheq akuzat duke thënë: “E pranoj se disa nga gjërat që thashë janë



të papranueshme. Unë respektoj maksimalisht punën e vështirë të FIFA-s dhe gjyqtarëve. Një Zotëri i vërtetë është ai që pranon gabimin dhe ky është rasti im për ato që thashë. Mendoj se gjyqtari Geiger gaboi si çdo njeri, por dua të jem i qartë dhe nuk kam asnjë dyshim në

lidhje me dashamirësinë e tij. I kërkoj ndjesë atyre që e kanë ndërjet veten të fyer nga fjalët e mia dhe i uroj punë të mbarë”, deklaroi Maradona. Maradona u pa gjatë ndeshjes me fanelën e Kolumbisë të veshur, ndërsa FIFA, pas deklaratave të tij tha: “Na vjen shumë keq që

një njeri që ka shkruar historinë e këtij sporti, flet në të tillë mënyrë”, thanë nga FIFA. Megjithatë, duket se tani është kthyer paqja. Maradona dhe FIFA kanë pasur relacione shumë të mira që kur Infantino mori vendin e Blatter si president.

## Ronaldo, më i shpejti në Rusi

Tani është zyrtare dhe e ka konfirmuar FIFA, Kristiano Ronaldo është futbollisti që ka regjistruar shpejtësinë më të lartë të arritur në “Rusi 2018”. Sulmuesi portugez, që është pranë transferimit te Juventus, arriti për një moment shpejtësinë 34 km/h. Por ja cilët janë 10 lojtarët më të shpejtë në këtë kampionat botëror, ata që kanë thyer kufirin e shpejtësisë 33 km/h:

1. Kristiano Ronaldo	34 km/h
2. Ante Rebiç	33.9 km/h
3. Luis Advincula	33.8 km/h
4. Santiago Arias	33.6 km/h
5. Kyle Walker	33.5 km/h
6. Jesse Lingard	33.4 km/h
7. Maceij Rybus	33.3 km/h
8. Markuinjos	33.3 km/h
9. Aleksandr Golovin	33.2 km/h
10. Dani Karvahal	33.1 km/h



## 200 mijë kolumbianë duan përsëritjen e ndeshjen ndaj Anglisë

Një peticion i firmosur nga rreth 200 mijë njerëz, më saktësisht 192.550 vetë, kanë kërkuar që ndeshja mes Anglisë dhe Kolumbisë, e vlefshme për 1/8-t e finaleve të “Rusi 2018”, të përsëritet. Tifozët e Kolumbisë, që kanë marrë iniciativën e tij peticioni, janë “tërbuar” nga gjykimi i amerikanit Greiger, që sipas tyre akordoi një penallti të paqenë në favor të “luanëve” dhe të shndërruar në gol nga Harry

Kin, në ndeshjen e mbyllur 1-1, ku Anglia u kualifikua me penallti. Gjithashtu, kolumbianët pretendojnë se në kohën shtesë iu anulua me të padrejtë një gol i Karlos Baka. 192 mijë njerëz firmosën peticionin e dërguar te FIFA për përsëritjen e ndeshjes, por mundësia që kjo të ndodhë është o për qind. Anglia do të luajë me Suedinë në çerekfinale të “Rusi 2018”, ndërsa Kolumbia është kthyer në atdhe.



## Përfundoi botërori për Danilon

Danilo i ka thënë lamtumirë Kupës së Botës në Rusi. Mbrojtësi i krahut të djathtë të Brazilit pësoi një lëndim gjatë stërvitjet para ndeshjes me Belgjikën, gjë që bëri të humbas vazhdimin e botërorit. Në fakt, ishte një shtrembërim i fortë të kyçit të majtë dhe pas teste mjekësore, vendosi që nuk ka kohë për rimëkëmbje, duke e detyruar Federatën e Futbollit të Brazilit të bëjë një njoftim për përfundimin e paraqitjet në garën e sivjetme. “Danilo ka një lëndim të fortë të ligamenteve dhe nuk do të

jetë në gjendje të luajë në pjesën tjetër të Kupës së Botës”, tha Dr Rodrigo Lasmar. Danilo, i cili do të qëndrojë i fokusuar me Brazilin deri në fund të pjesëmarrjes së ekipit në këtë Kupë Botëror, do të mund të kryej një ndërhyrje të vogël kirurgjike. Ylli i Manchester Sinit edhe në ndeshjen me Meksikën ishte zëvendësuar nga Fagner, i cili morri notë pozitive për paraqitjen në botëror. Ndryshe, Brazili dje u takua me Belgjikën në kuadër të çerekfinaleve të Kupës së Botës.

## Pritje heroike për futbollistët japonezë

Qindra tifozë japonezë kanë pritur në mënyrë spektakolare futbollistët e Kombëtares së tyre, pas një aventure jo shumë të shkurtër në kompeticionin Botëror të Rusisë. Kombëtarja e Japonisë arriti të shkojë në fazën e 1/8-ave, por Belgjika bëri çmendurinë duke eliminuar në sekondat e fundit në shifrat 3-2. Kultura japoneze ka arritur majat. Edhe pse u mundën me përmbysje, tifozët dhe futbollistët treguan qytetari duke pastruar nga mbetjet ushqimore stadiumin në “Rostov Arena”. Krahas tifozëve, shembull qytetarie treguan edhe futbollistët, të cilët gjetën kohë të pastronin



dhe të rregullonin dhomat e zveshjes duke lënë në fund edhe një shënim me mbishkrimin në gjuhën ruse: Faleminderit! Mediat në të gjithë botën i kushtuan

rëndësi të madhe këtij gjesti, por ceremonia e pritjes në stadiumin e “Neritës” në Tokio nga bashkëkombësit e tyre ishte spektakolare.





**DASHI** 21. mars - 20. prill

Duhet të vazhdoni të luftoni për të marrë rezultatet që meritoni, sidomos nëse në vendin e punës keni bërë shumë sakrificë. Gjatë kësaj të premteje, do të keni mundësi të zgjidhni disa keqkuptime në dashuri ose në familje. Jini më të qartë dhe më të vendosur.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Jeni gati për të riparë në mënyrë drastike disa vendime që keni marrë në të kaluarën. Ky është momenti për të sqaruar të gjitha keqkuptimet në vendin e punës ose në familje. Gjithë çfarë këshillohet për ju, është që të mos jeni shumë agresiv.



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Kjo ditë sjell keqkuptime të vogla në vendin e punës, por kjo gjë nuk duhet t'iu dekurajojë. Pavarësisht kësaj, mundësitë e mira nuk do të mungojnë. Në dashuri, parashikohen përgjigje shumë të mira.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Do të nisni të planifikoni dhe organizoni gjithë aktivitetet dhe udhëtimet që keni ndërmend të kryeni gjatë verës. Këshillohet që të jeni më shumë bashkëpunues, për shkak se sugjerimet e vlefshme të bashkëpunëtorëve tuaj do të jenë shumë të domosdoshme për realizimin e projekteve të reja.



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Në këtë moment do të ndiheni disi nën presion dhe kjo për shkak të disa gjërave që duhet ti kishit mbyllur me kohë. Në dashuri, një miqësi mund të transformohet në një raport më intim dhe romantik dhe kjo gjë do ju bëjë tejet euforik.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Kjo e premte do të jetë mjaft e rëndësishme për të kryer eksperimente të vogla profesionale. Keqkuptime të vogla në familje, mund t'iu prishin disi mbrëmjen. Bëni kujdes me mënyrën tuaj të të shprehurit.



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Jeni të tensionuar lidhur me një aktivitet të rëndësishëm për karrierën tuaj aktuale. Lënia e një përshtypje të mirë është thelbësore, kështu që tregohuni sa më të vendosur.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Do të jeni shumë emotiv dhe të ndjeshëm gjatë kësaj dite, kështu që shmangni përfshirjen në situata të cilat mund t'iu vendosin në siklet. Mos u përfshini nga ankthi në dashuri dhe mundohuni të ndiqni një kurs natyral të gjërave. Përgjigje të mira janë fare pranë.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të përfshihen në një projekt interesant, i cili do ju lejojë që të shprehni sa më mirë të gjitha kapacitetet tuaja. Parashikohen mundësi shumë të mira për të bërë takime të reja.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Duhet të jeni të gatshëm për të zgjidhur disa çështje të vështira në punë. Do të ketë momente tensioni me bashkëpunëtorët dhe do të jeni ju që do të vini pikën e fundit. Megjithatë duhet të tregoheni sa më diplomatë. Në dashuri do të ketë shkëndija të reja.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Kjo fundjavë do të jetë mjaft interesante për të rizgjuar ndjenjat dhe për të përmirësuar raportet me persona që nuk i shikoni prej kohësh. Në mbrëmje duhet të kujdeseni më shumë për veten tuaj dhe mirëqenien.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Ka ardhur momenti që të fitoni disa sfida të rëndësishme të cilat do ju lejojnë që të merrni një rol të ri në vendin e punës. Kur bëhet fjalë për dashurinë, prireni që të jeni shumë të tensionuar. Nëse ka dyshime për të zgjidhur, flisni hapur me partnerin/en tuaj.



LLOJ MAQINE PËR FOTOKOPIJE	MBRETI I ITAKËS	QË I PËRMBAHET TEKSTIT FJALË PËR FJALË	QYTET NË NIGERI	SHENJAT MUZIKORE KUPONI	▼	DUKURI E RE, DIÇKA E RE (shq.)
▶						
DISKUTIMI I GJERË						
▶						
AKTORI AMERIKAN, KEJXH SILVESTER STALONE			ATLETJA XHAMAJKASE, MERILIN DERË E VOGËL DERIÇKË (krah.)			
GAZ PANGJYRË (C2H6)					AMPER	
					EKSPERT BUJQËSOR	
GJYQTARIA NË NJË GARË						LËNDË
KIMISTI SUEDEZ, ALFRED	▼	PRINCIP	PJATA	PERËNDIA E DIELLIT NË EGJIPTIN E VJETËR	ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVOVË LËNDA BAZË PËR NGJYRA (kim.)	GENERAL MOTORS VEGËL MUZIK. FRYMORE (shum.)
VEPËR MUZIKORE DRAMATIKE SKENIKE						
					NJË PERIM (shq.) SOLISTJA BRITANIKE NGA FOTO	
DRU FRUTOR TROPIKAL					○	JO BOSH
						PENXHERE
FRYMA				E INDISË SHKA NGA SHKUPI, "...PALIKUQI"	○	
AKTORI AMERIKAN, MARVIN			KËNGËTARI, SHAQIRI LLOJ PETE PËR ËMBËLSIRA		○	QYTET NË NORVEGJI SHKRIMTARI FRANÇEZ, EMIL
	VENIA NË GADISHMËRI LUFTARAKE LLOJ VEPËR LETRARE SKENIKE				○	
GJERMANIA		SHTËPI MODE ITALIANE MJET UDHËTIMI E TRANSPORTI			○	SPANJA NJËSI E VOGËL USHTARAKE (shq.)
KANAL TELEVIZIV GJERMAN			KRONIKAT KANAL TV SHTETËROR TURK		○	ISH FUTBOLLISTI GJERMAN, UVE
TOKAT E BUKËS				GOJËTAR I MIRË IZABEL AXHANI	○	
QË KA TË BËJË ME METRIN					○	TITULL I LARTË TURK SUEIDIA
OKSIDI I TITANIT					○	VEND ME VATHË PËR BAGETITË

## FJALËKRYO KLASIK

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
11						■	12		
13					■	14			
	■	15			16		■	17	
18	19	■	20			21	■	22	
23		24	■	25			26	■	
27			28		■	29		30	
31				■	32				
33									

**HORIZONTALISHT :** 1. Zbutës i lëkundjeve në një makinë, fikatës; 11. Llogaria për mallin e shitur apo blerë; 12. Këngëtar i ynë, Adrian; 13. Paraardhësi jonë (shq.); 14. Tryezar (vjet.); 15. Pije e nxehtë orientale; 17. Lloj druri për ndërtim të anijeve; 18. Milimetër; 20. Aktor i vjetër amerikan, Xhek; 22. United Nation; 23. Kafshimi; 25. Radha, rreshti; 27. Shkalla e shpejtësisë, ritmi; 29. Element kimik (Te); 31. Ve peshku; 32. Metropoli francez; 33. Tërësia e shkencave për mjekimin e kafshëve shtëpiake.

**VERTIKALISHT:** 1. Pohues; 2. Pyll; 3. Emër i huaj mashkulli; 4. Fshatar, i fshatit; 5. Film tmerrri a llahtarie (shq.); 6. Izabel Axhani; 7. Titull i lartë turk; 8. Lumë në Mal të Zi; 9. Tymtorja; 10. Uzina ku bëhet pastrimi i naftës; 14. I vetvetishëm; 16. Aktorja franceze, Anuk; 19. Doktorëshë; 21. Ndjenjë respekti (shq.); 24. Në trajtë kokrrizash shumë të vogla; 26. Këngëtar, Shaqiri; 28. Prefiks me kuptim para (lat.); 30. Qytet në Koren Veriore; 32. Numri i Ludolfit.

ZGJIDHJET: N. ROTATOR, DEBATI, NIKOLAS, SS. OTI, ETAN, A. JURIA, N. AAK, GM. OPERA, LAKRA, BANANE, PLOT, ERA, INDIANE, LI, ILIR, ROR, MOBILIZIMI, D. BENETON, E. RTL, ANALET, ARAT, ORATOR, METRIKE, AGA, ANATAS, STAN, VERTIKALISHT, AMORTIZATOR, FATURA, GAXHA, ILIRI, SARAF, R. SALEP, AKI, MM, LEMON, UN, AJI, RENDI, E. TEMPI, TELUR, IKER, PARIS, VETERINARIA.



## Rruga shkrin si "akullore", tërbohen shoferët

Bitumi që ka shkrirë nga nxehtësia i ka detyruar shoferët në Australi të braktisin automjetet e tyre pasi gomat u veshën me katran. Deri në 50 shoferë mund të kenë të drejtën e kompensimit për incidentin në Queensland të martën, thanë njoftimet. "Asnjëherë nuk kam parë

ndonjë gjë të tillë dhe kur raportet filluan të vijnë dje, kjo ishte thjesht e pabesueshme", tha kryebashkiaku lokal Joe Paronella për ABC. Incidenti thuhet se ndodhi prej një ndryshimi të motit, dhe dëmtimi i rrugës pasi u riaftësua javën e kaluar.

## Mbipesha shkurton jetën për 12 vjet!



Shkencëtarë amerikane dhe holandeze njoftojnë se mbipesha trupore shkurton jetëgjatësinë. Për arritjen e këtij përfundimi shkencëtarëve iu deshën disa vjet studimi të hollësishëm të çështjes. Ekspertet e universiteteve në Birmingham të Alabames dhe Johns Hopkins në Maryland shqyrtuan të dhënat e grumbulluara prej vitesh nga sondazhet e agjencive federale mbi shëndet-

tin mes dhjetëra mijëra njerëzve. Doktor David Allison pranë universitetit të Alabames thotë se synimi i studimit ishte për të përcaktuar ndikimin që ka mbipesha në jetëgjatësinë e njeriut. Të dhënat e njoftuara në revistën e shoqatës amerikane të mjekësisë tregojnë se jeta e personave me mbipeshe trupore mund të shkurtohet 20 vjet, nëse mbipesha fillon rreth moshës 20 vjeçare. Gjithashtu, një grua e

re zezake me mbipeshe trupore mund të humbasë 4 deri 5 vjet të jetës se saj, ndërsa një grua e racës së bardhë po me mbipeshe trupore mund të humbasë nga 5 deri 8 vjet. Gjendja keqësohet për burrat. Një burrë i racës së bardhë me mbipeshe të madhe trupore mund të jetojë 12 vjet më pak, ndërsa një i ri zezak në të njëjtat kushte të mbipeshës trupore mund të jetojë 20 vjet më pak. Edhe një studim i shkencëtarëve holandez, botuar në revistën amerikane, shkencëtarët e mjekësisë arrin në të njëjtin përfundim pas shqyrtimit të të dhënave shëndetësore të rreth 3300 personave të përfshirë në studimin 55 vjeçar të Institutit Framingham në shtetin Massachusetts. Në studim thuhet se në përgjithësi, personat 40 vjeçarë me mbipeshe trupore jetojnë 7 vjet më pak sesa personat të së njëjtës moshë, por me peshë trupore normale. Autorët e studimit thonë se rastet e mbipeshës trupore janë më të përhapura në vendet e industrializuara dhe rekomandojnë që masat parandaluese dhe trajtimi i këtij problemi të bëhet përparësi e institucioneve shëndetësore.

## Kopshti zoologjik në Moskë i vë shqiponjës emrin e portierit!



Kopshti zoologjik në Moskë ka vendosur të nderojë Igor Akinfeev duke i vënë emrin e portierit shqiponjës madhështore që gjendet në këtë kopsht. Një mënyrë për të falënderuar portierin që i dha skuadrës së tij kualifikimin për në çerekfinalet e Kupës së Botës me penalltitë e pri-

tura ndaj Spanjës. Drejtoresha e kopshtit, Svetlana Akulova, tha: "I kemi vënë emrin Igor Akinfeev një shqiponje që erdhi në jetë vetëm pak muaj më parë. Ashtu si portieri i kombëtares tonë, ky shpend ka refleks mbresëlënëse dhe një shikim të jashtëzakonshëm".



KALENDARI HISTORIK 7 KORRIK

- 1495 - Mbreti Ferdinandi II kthehet në Napoli.
- 1543 - Trupat francez pushtojnë Luksemburgun.
- 1647 - Kryengritja kundër çmimeve të larta dhe sundimin spanjoll në Napoli.
- 1753 - Parlamenti anglez lejon shtetësinë hebrejo-angleze.
- 1807 - Franca, Rusia dhe Prusia nënshkruajnë Marrëveshjen e Paqes së Tilsitit.
- 1937 - Përleshja e trupave japoneze dhe kineze në Urën e Marko Polos.
- 1941 - Lufta e II Botërore: Trupat franceze dhe britanike pushtojnë Beirutin.
- 1953 - Çe Gevara nis udhëtimin e tij përmes Bolivisë, Perusë, Ekuadorit, Panamasë, Kosta Rikës, Nikaraguas, Hondurasit dhe El Salvadorit.
- 1960 - BRSS rrëzon një aeroplan amerikan mbi Detin Barent.
- 1972 - Femrat e para, anëtare të FBI, japin betimin (Susan Lynn Roley dhe Joanne E Pierce).



Pothuajse të gjithë njerëzit në botë kanë "merimangat" e veçanta në qerpikët e tyre të quajtur demodex.



Çdo ditë, trupi i njeriut humb rreth një milion qeliza të lëkurës - që arrijnë në 2 kg çdo vit. Në ndërkohë, një centimetër katror i lëkurës suaj përmban rreth njëqind centesorë dhimbjeje.



Syri i njeriut mund të dallojë deri në 10 milionë ngjyra të ndryshme. Por truri ynë nuk mund t'i kujtojë të gjitha ato.



BARSOLETA

### BRENDA ARKIVOLIT

Ne një funeral, burri që ndodhej brenda arkivolit trokiste dhe bërtiste:  
- Shpresaaaa, jam gjalle, hapeni këtë dreq kutie!  
- Mbylle mor ti gojën, se nuk e di me mire se doktori ti, ndyrësire e dreqit!



THËNIA E DITËS



Pa iluzionet nuk do të ketë pothuaj asnjëherë, madhështi të mendimeve, as forcë dhe zjarr të shpirtit, as veprime të mëdha, që në pjesën më të madhe janë çmendurira. **(Giacomo Leopardi)**